



USHTRIA



Viti i 74-të i botimit Nr. 42 (827740)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 15 Tetor 2021

Romë, takimi IX i Shefave të Shtabit të Përgjithshëm të vendeve të DECI



FARSH e gatshme për të rritur kontributin në angazhimet e përbashkëta në kuadër të NATO dhe BE

Në Romë, Itali u mbledhën shefat e Shtabit të Përgjithshëm të Italisë, Shqipërisë, Kroacisë, Sllovenisë, Austrisë, Malit të Zi dhe Hungarisë. Kjo në kuadër të iniciativës DECI për bashkëpunimin në fushën e Mbrojtjes. Shefat e Shtabit të DECI vlerësuan rolin e iniciativës ndër vite për paqen dhe sigurinë në drejtimin jugor

të Aleancës së NATO-s e në veçanti në rajonin e Adriatikut dhe Ballkanit. Në konferencë u diskutuan çështje që lidhen me rishikimin strategjik të iniciativës DECI, mësimet e nxjerra nga Forcat e Armatosura të vendeve gjatë përbashkëtimit të pandemisë së COVID-19, sfidat me të cilat përballlet rajoni,...

» faqe 2

Intervistë me toger Gliserda Nekaj

Togere Nekaj, me hapa të fortë e të sigurt në rrugëtimin e karrierës si ushtarake



» faqe 5

13 Tetori, Dita Ndërkombëtare e Ndërgjegjësimit ndaj Fatkeqësive “Të gjithë bashkë për Mbrojtjen Civile”

U shënua në kalendar, si një ditë që shërben për të rritur ndërgjegjësimin dhe rëndësinë e frenimit të riskut ndaj këtyre fatkeqësive. Motoja e kësaj dite: “vetëm së bashku” mundemi » faqe 3



Gradat ushtarake në Shqipëri

Gradat simboli i artë mbi supet e ushtarakut në karrierë

Gradat ushtarake historikisht kanë lindur në shekujt XV-XVI. Gradat ushtarake në Shqipëri janë përdorur pas vitit 1912. Në vitet 1920-1923 shteti dhe qeveria shqiptare me gjithë vështirësitë ekonomike, bëri gjithçka për trajtimin ekonomik-financiar të oficerëve dhe nënoficerëve, duke i siguruar kësaj sh-trese një rrogë mbi mesataren e shtresës së mesme të popullsisë. Prioritet i jepej pagesës së oficerëve, nënoficerëve të bazës...



» faqe 6-7

Programi akademik

KLSM vizitë në institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare të sigurisë dhe mbrojtjes në Kosovë

Në kuadër të programit akademik të Kursit të Lartë të Sigurisë dhe Mbrojtjes që po zhvillohet në AFA, nga data 5 tetor deri më datën 7 tetor, ky kurs kreu një vizitë mësimore në Republikën e Kosovës. Objekt i kësaj vizite ishte njohja e pjesëmarrësve të kursit në Institucionet Kombëtare dhe Ndërkombëtare të Sigurisë dhe Mbrojtjes në Kosovë. Për këtë qëllim sipas programit u vizituan disa institucione të rëndësishme...

» faqe 4



67 Vjetori i Asamblesë Parlamentare të NATO-s

Stoltenberg: Ne jemi më të fortë kur qëndrojmë së bashku

» faqe 8

KAREMAN HASKO

Doktori i Pilotëve ushtarakë shqiptarë

» faqe 10-11

QENDRA E PERSONEL REKRUTIMIT

Një hap i sigurt drejt suksesit

» faqe 14

Në Romë, Itali u mbledhën shefat e Shtabit të Përgjithshëm të Italisë, Shqipërisë, Kroacisë, Sllovenisë, Austrisë, Malit të Zi dhe Hungarisë. Kjo në kuadër të iniciativës DECI për bashkëpunimin në fushën e Mbrojtjes.

Shefat e Shtabit të DECI vlerësuan rolin e iniciativës ndër vite për paqen dhe sigurinë në drejtimin jugor të Aleancës së NATO-s e në veçanti në rajonin e Adriatikut dhe Ballkanit. Në konferencë u diskutuan çështje që lidhen me rishikimin strategjik të iniciativës DECI, mësimet e nxjerra nga Forcat e Armatosura të vendeve gjatë përbashkëtimit të pandemisë së COVID-19, sfidat me të cilat përballen rajoni, si dhe bashkëpunimi për ndërtimin e kapaciteteve të përbashkëta operationale.

Në këtë takim Shqipëria u përfaqësua nga një delegacion i kryesuar nga zëvendës shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Manushaqe Shehu.

Në fjalën e saj gjatë konferencës, gjeneralmajor Shehu përcolli përshëndetjet e shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Bajram Begaj duke konfirmuar gatishmërinë e FARSH për të rritur kontributin në angazhimet e përbashkëta në stërvitje, trajnim dhe forcat e gatshme në kuadër të NATO dhe BE.

Konferenca u përshëndet nga ndihmës sekretari për Mbrojtjen i Italisë, ndërkohë që pjesë e konferencës ishin edhe komandantët e misionëve të drejtuara nga NATO në Kosovë (KFOR) dhe BE në Bosnjë-Hercegovinë (ALTHEA), të cilët njohën pjesëmarrësit me zhvillimet më të fundit në zonat e tyre të përgjegjësisë.



Romë, takimi IX i Shefave të Shtabit të Përgjithshëm të vendeve të DECI

FARSH e gatshme për të rritur kontributin në angazhimet e përbashkëta në kuadër të NATO dhe BE

Shqipëria u përfaqësua nga një delegacion i kryesuar nga zëvendës shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Manushaqe Shehu



Fatkeqësitë natyrore nuk kanë kufij, kërkojnë veprime të vërteta dhe konkrete mbi klimën apo ngrohjen globale dhe politika të dakortësuar, prandaj dhe edicioni i vitit 2021 fokusohet në objektivin e 6-të të Kuadrit Sendai, që ka të bëjë me “bashkëpunimin ndërkombëtar për vendet në zhvillim për të zvogëluar riskun dhe humbjet nga katastrofat”, nëpërmjet motos “Të gjithë bashkë”.



13 Tetori, Dita Ndërkombëtare e Ndërgjegjësimit ndaj Fatkeqësive

“Të gjithë bashkë për Mbrojtjen Civile”

U shënua në kalendar, si një ditë që shërben për të rritur ndërgjegjësimin dhe rëndësinë e frenimit të riskut ndaj këtyre fatkeqësive. Motoja e kësaj dite: “vetëm së bashku” mundemi

Për të dytin vit radhazi, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile në kuadër të “Ditës Ndërkombëtare për Zvogëlimin e Riskut ndaj Fatkeqësive”, në bashkëpunim me Kryqin e Kuq shqiptar, Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP), World Vision Albania, prefekturat, bashkitë, si dhe Ministrinë e Arsimit dhe Shëndetësisë, risjell në 12 shkolla të vendit, aktivitetin me temë “Të gjithë bashkë për Mbrojtjen Civile”.

Marrë shkas nga thirrja e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara në vitin 1989, për të pasur një ditë ku vëmendja e shoqërisë në rang global të përqendrohej tek mundësia dhe aftësia që kanë njerëzit apo komunitetet në mbarë botën, që të zvogëlojnë ekspozimin e tyre ndaj fatkeqësive, 13 tetori u shënua në kalendar, si një ditë që shërben për të rritur ndërgjegjësimin dhe rëndësinë e frenimit të riskut ndaj këtyre fatkeqësive.

Fatkeqësitë natyrore nuk kanë kufij, kërkojnë veprime të vërteta dhe konkrete mbi klimën apo ngrohjen globale dhe politika të dakortësuar, prandaj dhe edicioni i vitit 2021 fokusohet në objektivin e 6-të të Kuadrit Sendai, që ka të bëjë me “bashkëpunimin ndërkombëtar për vendet në zhvillim për të zvogëluar riskun dhe humbjet nga katastrofat”, nëpërmjet motos “Të gjithë bashkë”.

Disa shkolla 9-vjeçare, në qytete si Tiranë, Durrës, Vlorë, Lezhë, do të mirëpresin këtë aktivitet, i cili do të shtrihet edhe në shumë sheshe të këtyre vendeve, për të vijuar gjatë ditës me diskutime të hapura dhe shpërndarjen e broshurave informuese pranë tendave në prani të përfaqësuesëve të AKMC-së, organizatave partnere, Ministrisë së Arsimit dhe Shëndetësisë, si dhe pushtetit vendor.

Shqipëria, vitet e fundit është përballur me një sërë fatkeqësish, si tërmetet, pandemia COVID-19, përmbytjet, e fundit ishte situata me zjarret masive të kësaj vere (2021). Të gjitha këto fatkeqësi evidentojnë se çfarë angazhimi në kapacitete njerëzore, institucionale, teknike dhe financiare kërkohen për raste të tilla emergjente, ku nuk mund



të mungojë dhe asistencë ndërkombëtare në rast përshkallëzimi të situatës, pa llogaritur kostot e dëmeve me pasoja në jetë njerëzish, të gjësë së gjallë, pronës dhe ambientit. Edhe pse situata e zjarreve evidentoi gatishmërinë e institucioneve,

strukturave operacionale, vullnetare dhe efikasitetin e mekanizmit të mbrojtjes civile në Shqipëri, sërish kjo nuk mjafton për sfidat e së ardhmes në kuadër të ndryshimeve klimatike. Prandaj kërkohet më tepër ndërgjegjësim, angazhim dhe

veprim i gjithsecilit nga ne, në mënyrë që të parandalohen rreziqe me pasoja më të mëdha.

Për të përcjellë tek brezat e rinj një kulturë parandaluese, reaguese dhe ripërtëritëse - përballë ngjarjeve

ekstreme të motit dhe rreziqeve të tjera me theks të veçantë edhe tek vetë motoja e kësaj dite që “vetëm së bashku” mundemi, vlen të theksohet edhe roli dhe kontributi i organizatave partnere në fushën e zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë, të cilat i janë bashkuar këtij aktiviteti.

Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP), në Shqipëri, aktualisht po kontribuon me forcimin e kapaciteteve rikuperuese të shpejta (RESEAL), në nivel qendror dhe vendor. Gjithashtu, do të ndihmojë AKMC-në në rritjen e kapaciteteve, përgatitjen e dokumentave strategjik kombëtar dhe asistencën e përgatitjes të atyre në nivel lokal. Një fokus të veçantë ka edukimi dhe standardizimi i kurrikulave për edukimin e brezave të ardhshëm në këtë fushë. World Vision, në Shqipëri, aktualisht është e angazhuar përmes projektit Ndërtimi i ripërtëritjes dhe aftësive për “Reduktimin e Riskut ndaj Fatkeqësive (RRF)”, me një fokus në komunitet dhe shkolla, i mbështetur nga UNICEF, SDG Acceleration Fund, nëpërmjet financimit të qeverisë holandeze. Kryqi i Kuq shqiptar, me një shtrirje në të gjithë Shqipërinë, me rreth 2500 vullnetarë aktivë dhe 90.000 mijë anëtarë, kontribuon gjithashtu në vazhdimësi, ku një nga programet më të rëndësishme të kësaj organizate është përgatitja dhe përgjigjja në raste fatkeqësish, si dhe ndërgjegjësimi. Vulllosa e një kulture ndërgjegjësimi në këtë fushë edhe për vitet që do të vijnë, kërkon angazhimin e të gjithëve së bashku me veprime të shtuara, parandaluese për mbrojtjen tonë dhe të planetit si një detyrë mbi të gjitha civile.

Në kuadër të programit akademik të Kursit të Lartë të Sigurisë dhe Mbrojtjes që po zhvillohet në AFA, nga data 5 tetor deri më datën 7 tetor, ky kurs kreu një vizitë mësimore në Republikën e Kosovës.

Objekt i kësaj vizite ishte njohja e pjesëmarrësve të kursit në Institucionet Kombëtare dhe Ndërkombëtare të Sigurisë dhe Mbrojtjes në Kosovë. Për këtë qëllim sipas programit u vizituan disa institucione të rëndësishme;

- Ditën e parë, kursi u prit nga Nënkrjetari i Komisionit të Sigurisë së Kuvendit të Kosovës, Z. Enver Dugolli (kolonel në R) dhe disa përfaqësues të këtij komisioni.

Në këtë takim u fol kryesisht për situatën në Kosovë e rajon, si dhe bashkëpunimin në fushën e sigurisë mes dy shteteve shqiptare.

Zv. Dekania e FMS në AFA, Dr. Etleva Smaçi informoi Komisionin e Sigurisë së Kosovës për bashkëpunimin në fushën akademike mes dy vendeve.

- Ditën e dytë, KLSM pati një pritje të veçantë nga Ministri i Mbrojtjes së Kosovës Z. Armend Mehja, i cili përmes një vështrimi të përgjithshëm përcolli gjatë tek kursantët mesazhet se transformimi i FSK - së është tashmë një proces që ka si synim final anëtarësimin në NATO të Kosovës.

Ministri i Mbrojtjes pati një bashkëbisedim të frytshëm me kursantët në lidhje me çështjet e sigurisë rajonale dhe me gjerë.

Takimet e rradhës në ditën e dytë ishin me Shefin e Shtabit të Përgjithshëm të FSK - së gjeneral brigade Jeton Dreshaj dhe Komandantin e KDS gjeneral brigade Irfete Spahiu. Të dyja këto takime në FSK u shoqëruan me diskutime mes kursantëve dhe mikpritësëve mbi



KLSM vizitë në institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare të sigurisë dhe mbrojtjes në Kosovë

Mehja: Transformimi i FSK-së është tashmë një proces që ka si synim final anëtarësimin në NATO të Kosovës

vizionin e FSK - së dhe aktivitetet në fushën e arsimit ushtarak.

KLSM u vizitua gjithashtu nga ambasadori shqiptar në Kosovë, Z. Qemal Minxhozi.

- Vizita mësimore u përmbyll me takimin në KFOR, ditën e tretë. KLSM u prit nga gjeneral brigade John P. Mailer.

Fokusi i këtij takimi ishte njohja me organizimin e KFOR-it dhe objektivat e KFOR në raport me konsolidimin e institucionet e sigurisë në Kosovë.

Krahas aktiviteteve akademike vizita shërbeu edhe për njohjen më të gjerë nga ana e kursantëve e historisë dhe traditave të popullit kosovar.



Objekt i kësaj vizite ishte njohja e pjesëmarrësve të kursit në Institucionet Kombëtare dhe Ndërkombëtare të Sigurisë dhe Mbrojtjes në Kosovë. Për këtë qëllim sipas programit u vizituan disa institucione të rëndësishme. Kursi u prit nga Nënkrjetari i Komisionit të Sigurisë së Kuvendit të Kosovës, Z. Enver Dugolli (kolonel në R) dhe disa përfaqësues të këtij komisioni.



Intervistë me toger Gliserda Nekaj

Togere Nekaj, me hapa të fortë e të sigurt në rrugëtimin e karrierës si ushtarake

Vrëm disa ditë më parë Gliserda Nekaj mori gradën toger një vajzë mjaft kura-joze, me një shpirt luftarak e që i pëlqejnë sfidat. E lindur në nëntor të 1991, vitin e demokracisë në qytetin e Përmetit ajo tashmë mban detyrën e pedagoges përgjegjëse në grupin komandues, Departamentin e Formimit Ushtarak. Me një eksperiencë katër vjeçare në FA ajo ndan me ne rrugëtimin e saj ushtarak.

Që prej prillit të 2017 ju jeni pjesë e FA-së, si vendosët ti bashkoheshit strukturave të ushtrisë?

Ndryshe nga çka supozohet të mendohet si fëmijë e një ushtaraku duhet të isha rritur me dëshirën, që në të ardhmen të trashëgoja pasionin e tim ati, realisht kurrë nuk e kisha kaluar nëpër mendime se në të ardhmen do të isha pjesë e FA-së. Çdo gjë erdhi spontanisht pasi ma sugjeroi si mundësi babai im në ato pak raste që e përmendte këtë gjë. Në 3 prill të 2017 nisa Kursin e Përgatitjes së Oficerit të Ri pranë Akademisë së Forcave të Armatosura, në Garnizonin “Skënderbej”, pas disa muajsh stërvitje dhe përgatitje intensive, mu dha mundësia të rris dhe ndërtoj aftësitë e mia profesionale e intelektuale në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë. Me ardhjen e datës së titullimit, të gjitha sakrificat morën vlerë duke u graduar me gradën e parë të oficerit “nëntoger”.

Keni studiuar për Akuakulturë në Universitetin Bujqësor të Tiranës një profesion shumë i veçantë, një formim shumë ndryshe nga ushtria. Pse në një moment të qenit pjesë në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë mori më shumë rëndësi?

Siç e thatë edhe ju më lartë ndoqa studimet e larta pranë Universitetit Bujqësor të Tiranës, e kënaqur me profilin që kisha zgjedhur, por nuk më mjaftonte vetëm kjo, me duhej diçka më sfiduese që të më shtynte drejt progresit.

Mbasi ju bashkova FA-së e gjeta veten goxha të përfshirë, e duke parë që në secilën ditë që kalonte të krijoheshin mundësi të ndryshme për tu përmirësuar dhe rritur profesionalisht me anë të kurseve dhe trajnimeve në fusha të ndryshme që FA të mundëson. Kështu gjithsecili prej nesh rritet në dije, gjë që e cila të ndihmon të pozicionohesh në detyrën më të përshtatshme në të cilën mundesh të kesh produktivitet të lartë, e kush nuk gjendet komfort në këtë fazë kur ti merr dije, rritesh profesionalisht dhe i realizon detyrat me kënaqësi...

Emërimi juaj i parë ka qenë si komandante toge në Batalionin Komando të Forcave Tokësore si ishte kjo eksperiencë për ju?

Ndërkohë që isha në ndjekje të



kursit bazë specializues në Logjistik ‘Transport’ më del emërimi në Batalionin Komando, me detyrë komandante toge, e si një oficer e sapo diplomuar kisha edhe unë ato pikëpyetjet e mia sesa e zonja isha unë për të realizuar detyrat që i përkisnin pozicionit tim. Paraprakisht çdo gjë ishte emocionuese, frikësuese, interesante, një ambient i panjohur dhe jashtë pritshmërive të mia, ama mundem të shpreh se mu desh shumë pak kohë të përshtatesha me detyrën, përgjegjësit dhe efektivin që kisha në varësi, e sot mund të them me bindje që “Masterin” më të mirë që mund të kisha bërë ishte të shërbeja në Batalionin Komando. Shpeshherë më

thoshin oficerë me gradë më të lartë se unë, se nuk mund të jesh një oficerë i mirë drejtues nëse nuk ke qenë një herë komandant toge në trup, sot i bashkohem krejtësisht këtij mendimi.

Cila ka qenë sfida juaj më e madhe, që nga momenti i bërjes pjesë në FA?

Si një person, që i ka qejf sfidat dhe i ndjek në përgjithësi nuk është se kam pasur ndonjë sfidë e cila mund të ketë lenë shenja në memorien time, përveç faktit të përshtatjes në ato pak muajit e fillimit si ushtarake me ambientin dhe frymën e rregullit dhe disiplinës karakteristike ushtarake.

Në shtator të 2020 ju morët



emërimin në Akademinë Forcave të Armatosura si pedagoge përgjegjëse në grupin komandues, Departamentin e Formimit Ushtarak si e pritet këtë emërim?

Realisht ka qenë e papritur, e pa menduar ndonjëherë. Unë ndihesha komode, e kënaqur në detyrën që kisha në Batalionin Komando dhe nuk e kisha në planet e mia të afërta për të ndryshuar detyrë, deri në momentin që mu propozua diçka tjetër. Nuk kisha si mund të thosha jo përpara këtij vlerësimi, sepse realisht për mua ishte vlerësim. Patjetër e kënaqur me mundësinë që mu dha nga njëra anë, ama nga ana

e thashë edhe pak më lart me anë të trajnimeve dhe kurseve të ndryshme specializuese, përfshirë gjuhët e huaja. E deri në momentin që këto mundësi u jepen dhe trajtohen njësoj për të dyja gjinitë nuk kam përse ta konsideroj të vështirë.

Çfarë dëshironi që të ndryshojë, ose të përmirësohet për gratë në shërbim?

Të ndryshoj? Nuk më vjen ndërmend ndonjë ndryshim për tu përmendur veçanërisht, përveç faktit që gratë të përfshihen gjithmonë e më tepër në detyra që në pamje të parë konsiderohen “detyra burrash”, unë besoj shumë



tjetër ishte ankthi i një detyre krejt ndryshe nga ato çka kisha hasur deri në ato momente. Por çdo gjë rrjedh dhe vjen spontanisht nëse detyrën nuk e konsideron thjesht një detyrë, deri në momentin që e realizon me dëshirë dhe të jep satisfaksion vetë fakti që të gjithë ne si staf ndërtojmë formimin ushtarak profesional dhe intelektual të këtyre të rinjve të cilët në të ardhmen do jenë oficerë drejtues të denjë.

Vetëm pak ditë më parë ju keni marr gradën toger sa e vështirë është për një femër të ngjisë shkallët e karrierës në ushtri?

Po, në datën 3 shtator unë mora gradën e radhës e cila është grada e Togërit. E kënaqur? Patjetër, gjë e cila më shtyn mos të resht së përmirësuar veten time si oficer e FARSH-së, dhe krenare njëkohësisht për këto arritje. Forcat e Armatosura të japin mundësi të arrish një përgatitje të mirë profesionale, fizike dhe intelektuale, e siç

në forcën e femrës dhe historia ka treguar që janë shumë të afta profesionalisht, ne kemi edhe zv/shëfen e Shtabit të Përgjithshëm shëbullin e duhur për rrugëtim ushtarak të një femre.

Nëse flasim për synimet që i keni vënë vetes, për karrierën tuaj në ushtri cilat janë planet e së ardhmes?

Patjetër që është rritja profesionale dhe intelektuale, gjë e cila më ndihmon që gradën e radhës ta kem më se të merituar. Plan së afërmi kam një kurs specializues jashtë shtetit i cili lidhet dhe specialitetin tim. E ndërgjegjshme për vështirësitë dhe sfidat që kalon çdo ushtarak nën uniformë, detyra që kryej më bën edhe më shumë krenare për profesionin që kam zgjedhur. Unë besoj dhe do të punoj me të gjitha energjitë e mia për të qenë një oficer e denjë. Në misionin që kam marrë të shërbej nën uniformë tani dhe në të ardhmen, me detyrat dhe përgjegjësitë që do të përballem.

Gradat ushtarake në Shqipëri janë përdorur pas vitit 1912

Gradat simboli i artë mbi supet e ushtarakut në karrierë

Gradat ushtarake historikisht kanë lindur në shekujt XV-XVI. Gradat ushtarake në Shqipëri janë përdorur pas vitit 1912. Në vitet 1920-1923 shteti dhe qeveria shqiptare me gjithë vështirësitë ekonomike, bëri gjithçka për trajtimin ekonomik-financiar të oficerëve dhe nënoficerëve, duke i siguruar kësaj shtrese një rrogë mbi mesataren e shtresës së mesme të popullsisë. Prioritet i jepej pagesës së oficerëve, nënoficerëve të bazës dhe jo të ministrisë. Në këtë periudhë buxheti i mbrojtjes dhe xhandarmërisë arriti rreth 45.7% të buxhetit kombëtar. Në vitet 1931-1932 ushtria dhe xhandarmaria harxhonte 14.429.515 Fr/Ari ose 45.18% të buxhetit kombëtar.

Sipas gradave pagat do të ishin si më poshtë;

- Ushtar 2 Fr\ari
- Tetar 4 Fr\ari
- Rreshter dhe kapiten 10 Fr\ari
- Aspirant 150 Fr\ari
- Nëntoger 200 Fr\ari
- Togër 200 Fr\ari
- Kapiten i II-të 250 Fr\ari
- Kapiten I klasit të parë (I-rë) 330 Fr\ari
- Major 420 Fr\ari
- Nenkolonel 500 Fr\ari
- Kolonel 600 Fr\ari

Duke pasur parasysh dhe vlerën që kishte Franga në Ar në atë kohë kuptohet dhe trajtimi dinjitoz i ushtarakëve. Pikërisht për këtë trajtim të nivele të larta do fliste dhe ish presidenti i Republikës së Shqipërisë Alfred Moisiu si biri i një ushtaraku major në periudhën e Zogut "edhe pse shteti i varfër im atë trajtohej mirë ekonomikisht, ushqimet na

vinin në shtëpi, jo se kishim me tepri, por në raport me popullatën, ekonomikisht ishim shumë më mirë." Ky ishte motivim që në ushtri të shkonte elita e kohës. Pikërisht kjo elitë do të ishte dhe në ballë të luftës Nacional Çlirimtare. Ata lanë privilegjet e ushtarakut që u ofronin dhe qeveritë kuislinge dhe dolën malit për çlirimin e Shqipërisë.

Historia e Sistemit të Renditjes Ushtarake

Struktura e rangut brenda ushtarakëve gjurmohet përsëri në ushtritë mesjetare ku njësi bazë e ushtrisë e komanduar nga një kapiten ishte kompania. Ndërsa operacionet ushtarake u zgjeruan, nevoja për më shumë radhë u rrit dhe ushtritë u bënë komplekse. Amerikanët trashëguan sistemin e renditjes nga britanikët që kishin adoptuar të njëjtën gjë nga romakët. Midis shekujve 17 dhe 18, si kolonel dhe kapiten ishin radhët e ngjashme edhe pse me kalimin e kohës, koloneli çuan më shumë regjente ndërsa kapitenët udhëhoqën kompanitë. Në ushtritë e hershme, duke përfshirë SHBA, radhët e ndryshme mbanin uniforma të ndryshme. Ushtritë bënë shenjë dalluese për të dalluar gradat, pasi armiqët mund të veçonin dhe eliminonin zyrtarët komandues duke parë uniformat e tyre. Me teknologji të përparuar dhe me nevoja të ndryshme ushtarake, vendet miratuan varietete të rangjeve. Dallimet e ndryshme dallohen në histori duke përfshirë simbolet e pendave, hekurudhave, rripave, shiritave, shiritave, gjykatave të armëve, shqiponjave, një lisi me lisi dhe bare mes tjerash dhe janë veshur në kapele, në gjoks, në gjoks, në bel, në

dore, dhe armë për njohje më të lehtë.

Gjatë karrierës ushtarake të gjithë kërkonin gradë sa më të lartë. Bashkë me to rritej autoriteti dhe rroga dhe shtoheshin privilegjet të tjera. Por jo gjithkush kishte të drejtë të gradohej. Duke parë përmasat e mëdha të marrjes së gradave, u pa e arsyeshme të vendoseshin rregulla të reja. I pyetur rreth kësaj teme Ish Komisar i Brigadës së Parë Sulmuese në Tiranë (ndarë para pak kohe nga jeta) Hetem Halili do shprehej për mediat: "Aso kohe ndodhën ca gjëra të tjera. Fjala vjen: po të mos mbarojë Akademinë Ushtarake, s'mund të kaloje nga Kapiteni i Parë në Major. Kështu pati hezitime, madje dhe kundërveprime. Ishin të shumta letrat ankuese, si në MM e KQ, se përse duhet të ndodhi një gjë e tillë dhe se ç'rëndësi kishte, nëse e mbarojë apo jo Akademinë. Sidomos, një pjesë ushtarakësh që kishin bërë Luftën, pretendonin se Akademia e tyre ishte vetë lufta dhe pjesëmarrja në të. Sipas tyre, përderisa kishin sakrifikuar në Luftë, u takonte të kalonin gradat e ulta për t'u futur tek oficerët madhorë. Ishte e vërtetë që ata e bënë luftën, e më pas filluan të merrnin dhe grada. Por një pjesë e tyre nuk e justifikonin, pasi nga ana e dijeve linin shumë për të dëshiruar dhe nuk kishin arsimin e mjaftueshëm. Sidoqoftë ushtria shqiptare qëndroi 25 vjet me radhë pa grada, dhe kështu vazhdoi për një kohë të gjatë. E megjithatë ishte një ushtri e mobilizuar mjaft mirë. Natyrisht që gradat ndikojnë shumë tek një ushtaraku dhe karriera e tij.

Karriera ushtarake është ecuria në rendin e gradave dhe funksioneve gjatë kryerjes së shërbimit ushtarak aktiv.

Në periudhën e diktaturës

Kongresi i Përmetit në maj 1944 vendosi që në Ushtrinë NÇL të përdoshin grada, por ato u mbajtën deri në mars 1966 kur Plenumi i 16-të i ish-PPSH vendosi të hiqeshin.

U hoqën me motivacionin se "ushqenin mendjemadhësinë dhe i shkëputnin kuadrot nga ushtarët dhe nga populli".

Pas Luftës së Dytë Botërore kur regjimi i Enver Hoxhës mori pushtetin, gradat ushtarake u ndryshuan rrënjësisht në pamje dhe në emër. Dizajni origjinal për gradat për UPSH erdhi nga Bashkimi Sovjetik dhe Blloku Lindor. Në maj 1966 gradat ushtarake u shfuqizuan pas kalimit të Splitit Sino-Sovjetik në shembullin kinez. Ashtu si të gjitha degët e tjera të shtetit, ushtria iu nënshtrua kontrollit të Partisë së Punës të Shqipërisë, me të gjithë oficerët e rangut të lartë ushtarak që ishin anëtarë të nivelit të lartë të PPSH. Sistemi politik u forcua përsëri me futjen e komisarëve politikë të ngjashëm me Ushtrinë e Kuqe Sovjetike brenda ushtrisë për të promovuar një edukim të gjerë politik krahas trajnimit të rregullt ushtarak. Për të rritur më tej kontrollin e tij politik, PPSH zgjeroi sistemin e rekrutimit duke regjistruar personelin e UPSH nga disa zona rurale shqiptare që ishin jashtëzakonisht besnikë ndaj shtetit.

Rradhët ushtarake përcaktojnë, se kush ka autoritet dhe kush përgjegjësi për çfarë. Kjo hierarki e autoritetit ishte

universale me ndryshime të vogla të emrave dhe të shenjave nga një vend në tjetrin dhe nga një degë ushtarake në tjetrën.

Edhe pse brenda nivelit të një shteti diktatorial, ushtarakët janë trajtuar me paga dhe trajtime të tjera si (veshje dhe ushqime) mbi mesataren e popullatës. Në harkun kohor mes viteve 1980-1990 shpenzimet për mbrojtjen shkonin 12-15% të totalit të buxhetit të shtetit.

1990 viti i ndryshimeve social-ekonomike

Në periudhën pas viteve 1990 me ndryshimet në të gjitha sferat e jetës edhe Forcat e Armatosura nuk mbetën jashtë, p.sh buxheti nga 12.7% në vitin 90' ra në 8.6% në 92'. Në këto kushte dhe pagat e ushtarakëve pësuan luhetjet e tyre. Në vitet 92' ushtarakët paguheshin sipas pozicionit në detyrë (komandat, drejtor), por përveç pagës bazë ushtaraku përfitonte dhe shtesë nga grada, vështirësi vendi, vështirësi arme, shërbimi etje. e cila shkonte 40-50% e pagës bazë.

Pas viteve 2000

Trajtimi financiar i ushtarakëve pësoi ndryshime.

U ndërtuan tabela pagash me gradë (kolonel, nënkolonel, major dhe deri gjeneral).

Por duke u hequr disa shtesa, si ato për vështirësi vendi dhe shërbimi.

Hierarkia ushtarake përfshin rendin e gradave dhe të funksioneve në FA që shkallëzohet nga më i ulëti tek më i larti. Ushtarakët, në varësi të hierarkisë së funksioneve dhe gradave, janë eprorë dhe vartës.



Ministri i Mbrojtjes, Niko Peleshi, i ka dhënë një rëndësi të madhe risisë që sjell Ligji për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura si garantim i rekrutimeve të sigurta si për trupën e ushtarëve ashtu edhe për oficerët.

“Ligji për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura ka si objekt përcaktimin e normave dhe të rregullave të hollësishme të rekrutimit, përparimit në karrierë, dhe liritë ose daljes në rezervë të ushtarakëve”.do te shprehej Peleshi,në marsin e këtij viti kur u shqyrtua Dekreti i Presidentit të Republikës, “Për kthimin e ligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin “Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë””, të ndryshuar”.

Qëllimi i këtij projektligji është përmirësimi i ligjit nr.59/2014, “Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, duke plotësuar disa mangësi që janë evidentuar ndër vite gjatë zbatimit të tij.

“Gjatë implementimit të ligjit në këto 6 vite përveç anëve pozitive të shumta që solli për FA, janë identifikuar edhe disa problematika, të cilat nevojitet të adresohen për të garantuar në të ardhmen një sistem të sigurt rekrutimi, rritje të performancës së personelit ushtarak dhe garantimin e karrierës së tyre në FA”, është shprehur Peleshi.

Ministri Peleshi nënvizoi se risitë që sjell ndryshimi i këtij ligji janë, “garantimi i rekrutimeve të sigurta si për trupën e ushtarëve ashtu edhe për oficerët. Trajtimin dinjitoz të studentëve ushtarakë që zgjedhin për të studiuar dhe më pas për të shërbyer në FA. Rritjen e konkurrencës për të përzgjedhur më të mirët për nën/oficerë aktivë nga personeli i ushtarëve në FA. Kushtet e kritere të njëjta për të gjithë personelin ushtarak nën/oficer dhe oficer në FA. Garantimi i përfitimit të trajtimit sipas statusit të ushtarakut edhe për gradat e ulëta. Mbështetjen e personelit me specialitete të veçanta në FA, për të cilët është konstatuar vështirësi në rekrutim dhe në trajtimin e tyre. Plotësimin e nevojave për ushtarë dhe në ato reparte ku kemi vështirësi për rekrutimin e tyre. Zgjidhjen e problematikës së ushtarakëve ndër vite që për ariye të ndryshme nuk kanë një urdhër lirimi nga FA. Rritja e pagave, rritja e trajtimit financiar sipas vështirësive. Rifillimi i trajtimit të munguar të kompensimit të ushqimit. Fillimi i sistemit të arsimit bachelor në FA”.

“Mbështetja që u jep ushtarakëve ky ndryshim ligji dhe mbështetja që do të vijojë të shtohet vit pas viti për ushtarakët në FA do të krijojë një bazë të fuqishme profesionale në realizimin e detyrave si brenda ashtu dhe jashtë vendit dhe më dinjitozë krah kolegëve të tyre në familjen e madhe të aleancës politiko-ushtarake NATO”, theksoi Peleshi.



Gradat dhe karriera ushtarake në FA
Sipas p/ligjit, karriera ushtarake është ecuria në funksion dhe rendin e gradave gjatë kryerjes së shërbimit ushtarak aktiv. Në draft përcaktohet se ushtarakët e Forcave të Armatosura janë ushtarakë të shërbimit aktiv dhe ushtarakë në rezervë. Ushtarakët e shërbimit aktiv janë ushtarakë të shërbimit të përkohshëm dhe ushtarakë të shërbimit të karrierës. Ushtarakët e shërbimit të përkohshëm janë oficerët me gradë nëntoger, toger dhe kapiten, nënoficerët me gradë nëntetar dhe tetar dhe ushtarët/detarët. Ushtarakë të shërbimit të karrierës janë oficerët me gradë major, nënkolonel, kolonel dhe oficerët me gradë madhore dhe nënoficerët me gradë rreshter, kapter dhe kryekapter. Ushtarakë të shërbimit aktiv në Forcat e Armatosura janë oficerë, nënoficerë dhe ushtarë/detarë. Në Forcat e Armatosura gradat u jepen oficerëve, nënoficerëve,

ushtarëve/detarëve, studentëve ushtarakë dhe ushtarakëve në rezervë.

Sipas p/ligjit të propozuar për miratim gradat ushtarake në Forcat e Armatosura klasifikohen:

a) Për oficerët aktivë: grada madhore; grada të larta;grada të ulëta.

b) Për nënoficerët aktivë: grada të larta; grada të ulëta.

Arsimimi dhe kualifikimi për përparim në gradë

Ushtarakët e Forcave të Armatosura, për të fituar gradën e radhës, duhet të plotësojnë kriteret e arsimit dhe të kualifikimit, si më poshtë vijon:

a) Oficerët:

i. **Nëntogeri,** për të fituar gradën e togerit, duhet të ketë kryer kursin bazë të oficerit ose kurse të njësuara me të sipas urdhrit të ministrit të Mbrojtjes;

ii. **Togeri,** për të fituar gradën e kapitenit, duhet të ketë kryer kursin e avancuar të oficerit ose kurse të njësuara me të sipas urdhrit të ministrit të Mbrojtjes;

iii. **Kapiteni,** për të fituar gradën e majorit, duhet të ketë kryer kursin themelor të oficerit të shtabit ose kurse të njësuara me të sipas urdhrit të ministrit të Mbrojtjes;

iv. **Majori,** për të fituar gradën e nënkolonelit, duhet të ketë kryer kursin e Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm ose kurse të njësuara me të sipas urdhrit të ministrit të Mbrojtjes;

v. **Nënkoloneli,** për të fituar gradën e kolonelit, duhet të ketë kryer kursin e lartë të oficerit ose kurse të njësuara me të sipas urdhrit të ministrit të Mbrojtjes;

vi. **Koloneli,** për të fituar gradën gjeneral brigade, duhet të ketë kryer kursin e lartë për sigurinë dhe mbrojtjen ose kurse të njësuara me të sipas urdhrit të ministrit të Mbrojtjes;

vii. **Gradimi gjeneral major/nënadmiral dhe gjeneral lejtnant/admiral** bëhet në bazë të meritave, përgatitjes dhe aftësive profesionale, të vlerësuara nga Komisioni i Veçantë

i Karrierës.

b) Nënoficerët:

i. **Nëntetari,** për të fituar gradën tetar, duhet të ketë kryer kursin bazë të nënoficerit;

ii. **Tetari,** për të fituar gradën rreshter, duhet të ketë kryer kursin e avancuar të nënoficerit;

iii. **Rreshteri,** për të fituar gradën kapter, duhet të ketë kryer kursin e lartë të nënoficerit;

iv. **Kapteri,** për të fituar gradën kryekapter, duhet të ketë kryer kursin e kryekapterit.

c) Ushtarët:

i. **Kursanti,** për të fituar gradën ushtar/detar I, duhet të ketë kryer stërvitjen bazë;

ii. **Ushtari/detari I,** për të fituar gradën ushtar/detar II, duhet të ketë kryer stërvitjen individuale të avancuar.

Kurset dhe kualifikimet e kryera brenda dhe jashtë vendit, për efekt të përparimit në gradë, për të gjitha llojet e gradave, njësohen me urdhër të ministrit të Mbrojtjes, me propozimin e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm. Kurset dhe kualifikimet e kërkuara nga legjislacioni në fuqi, që rregullon aktivitetin e Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes dhe të shërbimit të policisë kriminale ushtarake, njësohen me kurset dhe kualifikimet e kërkuara për marrjen e gradave sipas këtij ligji, me urdhër të ministrit të Mbrojtjes.

Simbolet e arta mbi supet e ushtarakëve janë vlerësim i arsimit,punës dhe përkushtimit të tyre në vite dhe si përfaqësuesit elitë të një kombi meritojnë gjithë vëmendjen për vlerësimin e kontributit te tyre.

Punoi: Anjeza Musollari

Referat;Dr.Kujtim Çako,

Prof,Dr Agim Binaj

Ligjit për Karrierën Ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë.



Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s merr pjesë në Sesionin e 67-të Vjetorit të Asamblesë Parlamentare të NATO -s

Stoltenberg: Ne jemi më të fortë kur qëndrojmë së bashku

MSC. MIMOZA GOLIKJA

Duke folur në Sesionin Vjetor të Asamblesë Parlamentare të NATO-s në Lisbonë më 11 tetor 2021, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, përsëriti rëndësinë e angazhimit të fortë ndaj NATO-s dhe lidhjes transatlantike. “Aleatët nuk bien gjithmonë dakord për çdo çështje”, -tha Sekretari i Përgjithshëm, “por në fund të fundit, ne të gjithë biem dakord për atë që ka vërtet rëndësi: Se ne jemi më të fortë kur qëndrojmë së bashku”, -shtoi ai.

Në fjalimin e tij, z. Stoltenberg tregoi se Asambleja Parlamentare e NATO-s “ka qenë një zë i fortë për vlerat tona demokratike, dhe ne duhet t’u ripërkushtohemi atyre ndërsa vazhdojmë të përshtasim Aleancën tonë”. Ai bëri thirrje për mbështetje dhe angazhim të vazhdueshëm të parlamentarëve për të ndihmuar në shndërrimin e vendimeve të NATO 2030, duke përfshirë rritjen e shpenzimeve të mbrojtjes.

Kriza në Afganistan nuk ndryshon nevojën që Evropa dhe Amerika e Veriut të qëndrojnë së bashku në NATO

Në fjalimin e tij në Sesionin e 67-të Vjetor të Asamblesë Parlamentare të NATO-s, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg, foli mbi rëndësinë e Aleancës dhe theksoi kontributet e Portugalisë si vend organizator i rradsës, i këtij event të rëndësishëm. “Portugalia është një aleate e fortë e NATO-s. Ju kontribuoni në sigurinë tonë të përbashkët dhe në mbrojtjen tonë kolektive në shumë mënyra të ndryshme. Ju ndihmoni në luftën kundër terrorizmit ndërkombëtar, përfshirë në Irak dhe Afrikë. Avionët dhe anijet portugeze janë pjesë e misioneve tona të policisë ajrore dhe operacioneve detare, forcat portugeze marrin pjesë në brigadën tonë shumëkombëshe në Rumani. Ju gjithashtu organizoni një numër të objekteve të ndryshme të NATO-s, përfshirë akademinë tonë të përparuar kibernetike që u përfundua jo shumë javë më parë. Ju gjithashtu ishit një vend pritës dhe një komb udhëheqës për stërvitjen më të madhe të NATO-s këtë vit, ‘Steadfast Defender 2021’. Të gjitha këto kontribute demonstrojnë angazhimin e fortë të Portugalisë ndaj NATO-s dhe lidhjes transatlantike”, -tha Stoltenberg. “Të gjithë aleatët e NATO-s, në të dy anët e Atlantikut, vazhdojnë të qëndrojnë pranë. E them këtë duke e ditur se aleatët nuk bien dakord gjithmonë për çdo çështje, por në fund të fundit, të gjithë jemi dakord për atë që ka vërtet rëndësi: Se jemi më të fortë kur qëndrojmë së bashku.”

Duke ju referuar Afganistanit ai tha se “Në Afganistan qëndruam së bashku për 20 vjet dhe së bashku, ne morëm vendimin për t’u larguar, pas raundeve të shumta të konsultimeve. Nuk ishte një vendim i lehtë, sepse u përballëm me një dilemë. Për të qëndruar dhe për të rrezikuar një luftë të përtërirë dhe një prani ushtarake të hapur, ose të largoheshim



dhe të rrezikonim që talebanët të ktheheshin në pushtet. Kthimi i talebanëve në Afganistan është një tragjedi për popullin afgan dhe zemërthyer për të gjithë ne që i mbështetëm gjatë gjithë viteve. Unë jam thellësisht mirënjohës për të gjithë ata që shërbyen nën flamurin e NATO-s”, -tha Sekretari i Përgjithshëm. “Investimi dhe sakrificat që bëmë nuk ishin të kota për 20 vjet, asnjë sulm terrorist nuk është kryer nga Afganistani në vendet tona dhe prania jonë ushtarake ndihmoi në krijimin e kushteve për përparim të rëndësishëm shoqëror dhe ekonomik. Duke parë përpara, bashkësia ndërkombëtare duhet t’i ruajë këto përfitime dhe të vazhdojë të kontribuojë në afganët në rrezik me qëllim që ata të jenë në siguri. Ne duhet të përdorim të gjithë fuqinë që kemi për t’i mbajtur talebanët përgjegjës për angazhimet e tyre, përfshirë kalimin e sigurt, të drejtat e njeriut dhe terrorizmin.” Stoltenberg tha se ai ka nisur në NATO, një vlerësim të plotë të angazhimit tonë në Afganistan, për të nxjerrë mësim. Sepse duke mësuar ne përshtatemi. Është shumë herët për të përfunduar rezultatin e këtij procesi, por një gjë është e qartë: kriza në Afganistan nuk ndryshon nevojën që Evropa dhe Amerika e Veriut të qëndrojnë së bashku në NATO.

Sfidat e sotme dhe nevoja për unitet transatlantik

“Në fakt, nevoja për unitet transatlantik është më e madhe tani sesa ka qenë në çdo kohë që nga përfundimi i Luftës së Ftohtë, sepse sfidat me të cilat përballemi janë shumë më të mëdha se çdo vend, apo kontinent, që mund të përballojë i vetëm. Rusia është përgjegjëse për veprimet agresive kundër fqinjëve të saj. Një grumbullim masiv ushtarak nga Deti Barents në Mesdhe dhe përpjekjet për të ndërhyrë në demokracitë tona”, -tha më tej në fjalimin e tij në Sesionin e 67-të Vjetorit të Asamblesë Parlamentare të NATO-s, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg, kur foli mbi sfidat me të cilat përballlet Aleanca. “Kina po përdor me forcë fuqinë e saj për të detyruar vendet e tjera dhe për të kontrolluar njerëzit e saj, Kina po na afrohet, në Afrikë, në Arktik dhe në hapësirën kibernetike, duke investuar në infrastrukturën tonë kritike, nga rrjetet 5G në portet dhe aeroportet. Por dhe kërcënime të tjera po shfaqen, përfshirë sulmet kibernetike, teknologjitet

përçarëse, përhapjen bërthamore dhe ndryshimin e klimës. Terrorizmi brutal vazhdon të ekzistojë si një kërcënim real. Pra, ne duhet të forcojmë NATO-n. Kjo është pikërisht ajo që udhëheqësit tanë vendosën të bëjnë në Samitin në qershor. Ata ranë dakord me NATO 2030, një axhendë ambicioze për sigurinë tonë të ardhshme. Kjo përfshin rritjen e elasticitetit kombëtar, për t’i bërë shoqëritë tona, infrastrukturën dhe zinxhirët e furnizimit më pak të prekshëm nga sulmet, rritjen e mbrojtjes sonë kibernetike, investimin në teknologjitë më të fundit, dhe adresimin e ndikimit të ndryshimit të klimës në sigurinë tonë.”

Duke folur për rëndësinë e bashkëpunimit NATO-BE, Sekretari i Përgjithshëm tha se së bashku, do të vazhdojmë të trajtojmë paqëndrueshmërinë, të luftojmë terrorizmin dhe të ruajmë rendin ndërkombëtar të bazuar në rregulla, duke rritur trajnimin dhe ngritjen e kapaciteteve për partnerët dhe duke thelluar marrëdhëniet tona me vendet e

tjera, organizatat ndërkombëtare, sektorin privat dhe institucionet akademike. “Një partner që ka një rëndësi të veçantë për Aleancën tonë është BE dhe ne po bashkëpunojmë gjithnjë e më ngushtë me Bashkimin Evropian dhe jam i lumtur që punoj me Presidenten Ursula von der Leyen dhe Presidentin Charles Michel në një Deklaratë të re të Përbashkët, për të forcuar më tej marrëdhëniet NATO-BE, që do të jetë gati para fundit të këtij viti. Unë mirëpres fuqimisht përpjekjet e shtuara të BE-së në mbrojtje. NATO u ka bërë thirrje aleatëve evropianë që të investojnë më shumë dhe të ofrojnë më shumë aftësi të nivelit të lartë për shumë vite. Por këto përpjekje nuk duhet të dyfishojnë NATO-n. Kombet tona kanë burime të fundme, vetëm një grup forcash dhe ne duhet t’i përdorim ato në mënyrën më të mirë të mundshme”, -tha Stoltenberg. Lidhur me shpenzimet e mbrojtjes Sekretari i Përgjithshëm, tha se dorëzimi i vendimeve të NATO-s 2030 kërkon financim të duhur. “Ne jemi në rrugën e duhur”, -tha ai me shtatë vjet rresht të rritjes së shpenzimeve të mbrojtjes nga aleatët evropianë dhe Kanadaja, përfshirë nga Portugalia, si të gjithë aleatët e tjerë evropianë. Është thelbësore të mbajmë këtë vrull. Për këtë, unë besoj në mbështetjen tuaj të vazhdueshme. Sepse ju jeni ata që në fund vendosni buxhetet tona të mbrojtjes. Nuk ka të bëjë vetëm me shpenzimin e sa më shumë”, por “bëhet fjalë edhe për ta bërë këtë së bashku. Financimi më i zakonshëm është një shumëzues i forcës, një investim në unitetin transatlantik dhe një mesazh i fortë i unitetit dhe vendosmërisë sonë. Pra, ne duhet të rrisim fondet e përbashkëta të NATO-s, bazuar në kërkesat”, -tha ai. Koncepti i Ri Strategjik i NATO-s ishte një çështje tjetër e trajtuar nga Jens Stoltenberg në NATO PA. “Më

në fund, si pjesë e NATO-s 2030, ne gjithashtu ramë dakord për të zhvilluar Konceptin e ardhshëm Strategjik të NATO-s. Do të na japë një mundësi për të përcaktuar rrugën përpara për Aleancën dhe riafirmojë qendërsinë e lidhjes transatlantike për sigurinë dhe mbrojtjen tonë. Ai na jep gjithashtu mundësinë për t’u ripërkushtuar vlerave tona kryesore, demokracisë, sundimit të ligjit dhe lirisë individuale. Udhëheqësit tanë do të miratojnë Konceptin e ardhshëm Strategjik në Samitin e Madridit në 2022”, ndërkohë ai tha se “unë kam filluar konsultimet e brendshme me aleatët mbi mjedisin strategjik, qasjen dhe përparësitë në zhvillim të NATO-s. Unë gjithashtu do të thërras seminare në kryeqytetet aleate për të sjellë së bashku udhëheqjen e NATO-s, zyrtarët dhe komunitetet e ekspertëve dhe pres një angazhim të fuqishëm me Asamblenë Parlamentare të NATO-s në javët dhe muajt në vazhdim” ai theksoi se kjo Asamble Parlamentare ka qenë një zë i fortë për vlerat demokratike të NATO-s dhe “ne duhet të ri-angazhohemi për të ndërsa vazhdojmë të përshtatim Aleancën tonë”. Stoltenberg tha se së bashku me Presidentin Connolly i kanë trajtuar se si mund ta bëjmë këtë në shumë takime, gjithashtu në takimin tonë të fundit në Uashington D.C. Ai tha se e mirëpret faktin që iniciativat janë ndërmarrë në mënyrë që të kemi një debat të vërtetë se si mund të forcojmë më tej NATO-n si një mjet për të mbështetur vlerat tona kryesore demokratike, dhe theksoi se rënia dakord me rezolutat e rëndësishme në Ansamble “do të ndihmojnë në drejtimin e qeverive tona dhe parlamenteve tuaja ndërsa ne i kthejmë vendimet e NATO-s 2030 në veprim, duke u mbështetur siç tha ai në mbështetjen dhe angazhimin tuaj të vazhdueshëm, për ta mbajtur lidhjen transatlantike të fortë, NATO-n e fortë dhe njerëzit tanë të sigurt.

PËRPPJEKJET 20 VJEÇARE TË NATO-S NË AFGANISTAN

Stoltenberg: Ne shkuam në Afganistan në mbështetje të Shteteve të Bashkuara

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Smori pjesë në aktivitetin gjerman mbi vlerësimin fillestar të përpjekjeve në Afganistan. Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg foli praktikisht në një ngjarje të nivelit të lartë të organizuar më 6 tetor 2021, nga ministrja e Mbrojtjes e Gjermanisë, Annegret Kramp-Karrenbauer mbi vlerësimin fillestar të përpjekjeve njëzetvjeçare të NATO-s në Afganistan.

“Të gjithë aleatët e NATO-s ranë dakord të shkojnë në Afganistan në mbështetje të Shteteve të Bashkuara. Ne kishim një qëllim të qartë. Për të parandaluar që Afganistani të shërbejë si një strehë e sigurt për terroristët që kërcënojnë kombet tona. Ne e përmbushëm atë qëllim. Misioni ynë ushtarak nuk ishte i kotë. Për dy dekada nuk ka pasur sulme terroriste në tokën aleate



të organizuar nga Afganistani”, -tha Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s.

“Në të njëjtën kohë, bashkësia ndërkombëtare, e mbështetur nga prania jonë ushtarake, u angazhua në ndërtimin e kombit dhe reformën politike, duke ndihmuar në krijimin e kushteve për afganët për të bërë

përparim të rëndësishëm social dhe ekonomik. Unë jam mirënjohës për të gjithë ata që shërbyen nën flamurin e NATO-s dhe nderoj sakrificën e mijëra trupave, nga aleatët, partnerët dhe Afganistani, të cilët kanë paguar çmimin përfundimtar, përfshirë 59 trupa gjermane”, -shtoi ai.

KËSHILLTARËT E SIGURISË KOMBËTARE TAKIM NË BRUKSEL

Jens Stoltenberg: Aleanca ka nevojë për sigurinë tonë të përbashkët

Këshilltarët e Sigurisë Kombëtare nga e gjithë Aleanca e NATO-s, u takuan në Bruksel në 7 tetor 2021, për të shqyrtuar përparimin në fushat kryesore, duke përfshirë rritjen e parandalimit dhe mbrojtjes, inovacionin teknologjik dhe reagimin ndaj ndryshimeve klimatike. “Takimi i sotëm ishte një hap i rëndësishëm drejt Samitit të NATO-s në Madrid vitin e ardhshëm, ku ne do të vazhdojmë përshtatjen tonë ushtarake dhe politike”, -tha Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s pas takimit. Ai tha se trajtuam rëndësinë e shpenzimit më shumë për mbrojtjen dhe investimin në aftësitë që Aleanca ka nevojë për sigurinë tonë të përbashkët. Kjo përfshin financime shtesë për të mbuluar të tre buxhetet e NATO-s, ushtarake, civile dhe infrastrukturën.” Zoti Stoltenberg tha se Këshilltarët e Sigurisë Kombëtare diskutuan dokumentin e ardhshëm zyrtar të strategjisë kryesore të NATO-s, “Kon-

ceptin e ardhshëm Strategjik”, i cili do të miratohet në Samit. Për Afganistanin, Sekretari i Përgjithshëm përsëriti nevojën që NATO të bëjë pjesën e saj për të ndihmuar në ruajtjen e fitimeve të arritura në luftën kundër terrorizmit. Ai shtoi se diskutimet prekën gjithashtu mësimet që mund të nxirren nga angazhimi 20-vjeçar i Aleancës në Afganistan. Duke iu kthyer marrëveshjes së fundit AUKUS që çoi në mosmarrëveshje midis disa aleatëve, Sekretari i Përgjithshëm theksoi nevojën për kohezion në lidhje me qëllimet strategjike të Aleancës. “Si aleatë, ne nuk shohim gjithmonë sy më sy në gjithçka, gjatë gjithë kohës. Por ne nuk e humbasim kurrë pamjen e madhe”, - tha zoti Stoltenberg. Në një kohë të rritjes së konkurrencës globale, Evropa dhe Amerika e Veriut duhet të vazhdojnë të qëndrojnë të fortë së bashku në NATO.



NATO njofton Samitin në Madrid, 29-30 qershor 2022

Samiti i ardhshëm i NATO-s do të mbahet në Madrid më 29-30 qershor 2022, njoftoi kryeministri spanjoll Pedro Sánchez gjatë vizitës të Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s Jens Stoltenberg më 08 tetor 2021 në Madrid, Spanjë. Sekretari i Përgjithshëm u takua gjithashtu edhe me Mbretin e Spanjës, Madhërinë e Tij Felipe VI në pallatin Zarzuela.

Në bisedimet e tij me Kryeministrin Sánchez, së bashku me ministrin e Jashtëm José Manuel Albares Bueno dhe ministrin e Mbrojtjes Margarita Robles Fernández, Stoltenberg shprehu mirënjohjen e tij për Spanjën, për mikpritjen e Samitit të ardhshëm. Ai vuri në dukje se Samiti do të shënojë dyzet vjetorin e pranimit të Spanjës në NATO. “Ky anëtarësim ankoroj Spanjën në mesin e vendeve të lira dhe demokratike të komunitetit transatlantik, dhe gjithashtu hapi rrugën për anëtarësimin e vendit tuaj në BE disa vjet më vonë”, - tha Stoltenberg.

“Ne duhet të vazhdojmë të përshtatemi për të ardhmen. Dhe kjo është pikërisht ajo që ne do të bëjmë në Samitin e Madridit vitin e ardhshëm”, - tha Sekretari i Përgjithshëm. Në takim, udhëheqësit do të marrin vendime të rëndësishme për të zbatuar agjendën ambicioze të NATO-s 2030, theksoi zoti Stoltenberg, duke përfshirë rritjen e elasticitetit të Aleancës dhe mbrojtjes kibernetike, mpohjen e përparësisë së saj teknologjike dhe adresimin e ndikimit të sigurisë të ndryshimeve klimatike. Koncepti i ardhshëm Strategjik i NATO-s gjithashtu do të miratohet në Samitin e vitit 2022, theksoi Sekretari i Përgjithshëm. “Koncepti Strategjik i Madridit do të pasqyrojë mjedisin e ri të sigurisë, do t’i bindet përsëri vlerave tona dhe do të riafirmojë unitetin tonë. Sigurimin, që Aleanca jonë është e përshtatshme për të ardhmen”, - tha ai.

Sekretari i Përgjithshëm falënderoi Spanjën për angazhimin e saj të fortë ndaj NATO-s, përfshirë kontributet e saj në misionin stërvitor të NATO-s në Irak, grupin luftarak shumëkombësh të NATO-s në Letoni, avionët e saj në misionin e Policisë Ajrore Baltike dhe dislokimet e shumta detare. “Spanja është gjithashtu një mbështetëse e fortë e partneritetit të NATO-s me Bashkimin Evropian. Bashkëpunimi NATO-BE ka arritur nivele të pashembullta në vitet e fundit”, - tha Stoltenberg.

Stoltenberg: Ne duhet të vazhdojmë të përshtatemi për të ardhmen



PARTNERITETI NATO-GJEOGJJI

Mbështetje e vazhdueshme, Komiteti Ushtarak i NATO-s viziton Gjeorgjinë

Më 7-8 tetor 2021, Komiteti Ushtarak i NATO-s ishte në Gjeorgji, ku mbajti një takim special në Formatin e Gjeorgjisë dhe vizitoi Qendrën e Përbashkët të Trajnimit dhe Vlerësimit NATO-Gjeorgji. Përveç kësaj kryetari i saj, Admirali Rob Bauer u takua me Presidentin gjeorgjian Salome Zourabichvili, kryeministrin Irakli Garibashvili, ministrin e Mbrojtjes Juansher Burchuladze dhe shefin e Mbrojtjes, gjeneralmajor Giorgi Matiashevili.

Me mbërritjen e tyre në Tbilisi, Përfaqësuesit Ushtarakë të NATO-s vizituan Qendrën e Përbashkët të Trajnimit dhe Vlerësimit NATO-Gjeorgji, e cila është e përkushtuar për të ndihmuar Gjeorgjinë të reformojë, modernizojë dhe forcojë sektorët e saj të sigurisë dhe mbrojtjes. Komiteti Ushtarak u njoh me mënyrën se si JTEC i mundëson Gjeorgjisë dhe NATO-s të punojnë krah për krah dhe të eksplorojnë mundësi trajnimit dhe stërvitjeje shumëkombëshe të krijuara për të rritur ndërveprimin. Komiteti mori njoftime të hollësishme mbi stërvitjen e vazhdueshme luftarake, stërvitjet dhe aktivitetet midis forcave gjeorgjiane dhe forcave aleate dhe partnere. Në takim me kryeministrin gjeorgjian, z. Irakli Garibashvili, admirali

Bauer përsëriti rëndësinë e këtij partneriteti për NATO-n. “Kjo vizitë e katërt e Komitetit Ushtarak është një mundësi për të përsëritur angazhimin e palëkundur të NATO-s ndaj Gjeorgjisë. NATO dhe Gjeorgjia ndajnë një partneritet unik, i cili është bërë më i fortë me kalimin e kohës. Ne kemi ndërtuar këtë marrëdhënie për gati 30 vjet, bazuar në respektin reciprok, dialogun konstruktiv dhe bashkëpunimin praktik. Partneriteti ynë ka qenë gjithmonë reciprokisht i dobishëm. Kjo i bën si Gjeorgjinë dhe Aleancën më të fortë”, - tha admirali.

Duke u takuar me ministrin e Mbrojtjes, Z. Burchuladze dhe shefin e Mbrojtjes, gjeneralmajor Giorgi Matiashevili, admirali Bauer shprehu falënderimet e tij të përzemërta për Gjeorgjinë për mbështetjen e vazhdueshme ndaj NATO-s dhe për sakrificat e bëra në emër të sigurisë së përbashkët. “Për gati tre dekada, Aleanca kurrë nuk i ka bërë thirrje Gjeorgjisë më kot. Gjeorgjia ishte kontribuesi më i madh i trupave jashtë NATO-s në misionet tona në Afganistan. Gjeorgjia gjithashtu ka mbështetur misionin e KFOR-it të NATO-s në Kosovë për gati një dekadë; duke dhënë një kontribut të rëndësishëm në stabilitetin e rajonit. Dhe që nga viti 2015, Gjeorgjia po kontribuon në Forcën e Përgjigjes së NATO-s që i

mundëson NATO-s të mbetet e aftë dhe e gatshme”, - theksoi admirali Bauer.

Komiteti Ushtarak mbajti një takim special në ‘Gjeorgji Format’ me një delegacion të nivelit të lartë gjeorgjian përfshirë ministrin e Mbrojtjes Burchuladze, zëvendësministrin e Parë të Mbrojtjes Lela Chikovani dhe shefin e Mbrojtjes, gjeneralmajor Giorgi Matiashevili. Përfaqësuesit Ushtarakë të NATO-s morën përditësime mbi zbatimin e reformave të mbrojtjes gjeorgjiane, Paketën substanciale NATO-Gjeorgji dhe mjedisin aktual të sigurisë rajonale. Përfaqësuesit Ushtarakë të NATO-s dhe përfaqësuesit gjeorgjianë diskutuan se si mund të krijojnë më së miri optimizimin e mbrojtjes gjeorgjiane. “Në Tbilisi, statuja Kartlis Deda (Nëna Gjeorgji) mban një tas verë për të përshëndetur ata që vijnë si miq, dhe një shpatë për ata që vijnë si armiq. NATO është krenare që përshëndetet si një mik dhe ne do të bëjmë gjithçka që mundemi për të forcuar shpatën që mbart Gjeorgjia. Partneriteti ynë na forcon të gjithëve”, - tha Kryetari i Komitetit Ushtarak të NATO-s. Admirali Bauer përfundoi vizitën me takimin me Presidentin gjeorgjian, H.E. Salome Zourabichvili.

OFRIM I KUJDESIT
DHE MBËSHTETJES

Aleanca, përpjekje të përbashkëta për të zhvendosur afganët që punuan me NATO-n

80 ish-punonjës afganë të NATO-s dhe anëtarët e familjeve të tyre u zhvendosën në Norvegji. Ata u nisën nga objektet e përkohshme në Kosovë me një fluturim të linjës ajrore civile nga Prishtina në Norvegji në 05 tetor 2021. Trupat e Forcës së Reagimit me gatishmëri të lartë të NATO-s kanë ndihmuar në ofrimin e kujdesit dhe mbështetjes, duke përfshirë banesat individuale dhe familjare, ambientet e ngrënies, qendrat mjekësore dhe dentare, dhomat e takimeve, zonat rekreative për të rriturit dhe fëmijët dhe strehimet fetare.

“Ne jemi këtu në Prishtinë për të siguruar transportin e 80 refugjatëve afganë të lidhur me NATO-n”, pas “një kërkesë nga NATO”, tha Alan Aguillar, Këshilltar i Lartë për Policinë Norvegjeze të Imigracionit. “Ne bëmë një verifikim dhe kontroll të identitetit dhe sot po përfundojmë procesin për transferimin e këtyre refugjatëve në Norvegji. Ata do të transferohen në një kamp, ku ne do të vazhdojmë një proces integrimi atje. Ata do të zhvendosen në të gjithë vendin, pas disa javësh në këtë kamp. Ne do të bëjmë gjithçka që mundemi për t’i ndihmuar ata të ndërtojnë një të ardhme dhe një jetë të re në Norvegji”, - shtoi ai. “Ne kemi pasur një bashkëpunim dhe koordinim të mirë me NATO-n në terren. Ka qenë një proces i qetë nga fillimi në fund.”


Ndërsa disa afganë përfundojnë zhvendosjen e tyre, procesi vazhdon për të tjerët. Rreth 2,000 afganë që punuan me NATO-n dhe familjet e tyre, u evakuuan nga Kabuli në gusht, si pjesë e misionit më të madh të evakuimit në historinë e NATO-s. NATO punoi gjatë gjithë kohës për të koordinuar evakuimet dhe përfaqësuesi i lartë civil i NATO-s, ambasadori Stefano Pontecorvo dhe stafi i tij luajtën një rol kyç në këtë drejtim. Gjatë dy javëve, më shumë se 120,000 njerëz u dërguan jashtë, në qindra fluturime aleate. Trupat nga SHBA, Britania e Madhe, Turqia dhe Norvegjia luajtën një rol kyç në sigurimin e aeroportit dhe funksionimin e një spitali në terren, ndërsa rreth 800 punonjës të NATO-s mbanin operacionet kryesore si furnizimi me karburant dhe komunikimet.

Kareman Hasko

Doktori i Pilotëve ushtarakë shqiptarë

PROF. ASOC. DR. ZAHO GOLEMI

Kareman Abas Hasko (Aliaj) është një emër i njohur i aviacionit ushtarak shqiptar. Ai nuk ishte pilot, por mjek ushtarak, mjek i tre aerodromeve. Ai përgatiste djemtë e kaltërsive, i niste dhe i priste plot emocion, djemtë e Shkollës së Aviacionit, i dërgonte në fluturime të ëndërrimeve të bardha edhe pse me mision luftarak. Ai ishte dhe mbeti shpirti plot emocion i studentëve për pilotë, që çanin kryq e tërthor qiejt e kaltërsive dhe bardhësinë e reve, pilotonin guximshëm në prehër të qiellit dhe riktheheshin buzagaz tek kontrolli mjekësor i doktor Kareman Haskos. Edhe pse me emër hero i nuk u ndje kurrë hero por mbeti njerëzor deri në frymën e fundit. I njihte emër për emër gjithë pilotët, “kishin shkuar në dorë të tij”, i kishte matur emocionet si askush dhe u kishte dhënë leje të ngriheshin në kaltërsitë e Republikës. “Varka” e jetës së tij u mbush me vite, me njerëzillëk, me halle e shpresa, ku mbizotëroi gëzimi. Buzëqeshja e shpirtit ja kalon çdo lloj buzëqeshjeje. Prandaj mbeti përgjithmonë sikurse thotë i biri, Astriti, “i thjeshtë, i durueshëm, i respektueshëm, korrekt, i dashur, i ndershëm, i drejtë, i zoti, kurajoz, optimist, i kulturuar, i sakrificës e familjar shembullor” Doktor Karemani jetoi një jetë krenare, dinjitoze duke materializuar njerëzoren dhe shpirtbardhësinë. Prandaj shprehja “bëmë Baba të të ngjaj” është plotësisht e materializuar dhe e vërtetuar si një aksiomë popullore e pagabushme. Doktor Karemani ishte një misionar në jetë dhe këtë mision e vijon Astriti. Po edhe e tejkalon kur nuk lejon që një jetë e gdhëtur në dashuri njerëzore e babait e sjell në një libër të posaçëm për të: “Një jetë kushtuar mjekësisë”, Kujtimet e mjekut të aviacionit Kareman Abas Hasko (Aliaj). Prandaj edhe bilbili i gjuhës shqipe Naim Frashëri shkruante: “Mos thuaj se vdes njeriu./Se, është fjalë çilimi./Tek i biri, jetëgjati./ Është mbështetur i ati.”. Jeta e doktor Karemanit është një “ditar”, që edhe pse e ka shkruar vetë, në pentagramin e shpirtit ja hedh në letër i biri. Ku ka më bukur! Kështu jeton e gjallon më gjatë, por dhe shtrihet në të gjithë brezat që e trashëgojnë mirësinë e tij. Lumturia e agimeve të brezave të së ardhmes do “kullosin” shpirtin qetësisht në hijet e ëmbëla të së kaluarës. Kështu kujtimi i dr. Karemanit do të jetë dhe më afër, dhe më i prekshëm, këshillues, i përjetshëm si dëshira e njerëzve të zemrës si dhe shokëve, miqve e kolegëve të tij. Dhe brezat që do të vijnë do të dinë ta “ndeizin” jetën nën dritën e qiririt të mirësisë që nuk fiket kurrë, që dhe brezat të përjetojnë emocione të papërmbajtshme jetësore si emocionet e ndjenjat njerëzore të brezit të hekurt të doktor



Karemanit, këtij obelisk me mendje të shkathtë dhe profesionist i mjekësisë e shpirttrave njerëzorë. Libri i Astrit Aliaj është përshkruar me vërtetësi jetësore, plot çaste lumturie dhe krenarie të ligjshme, që përcjellin besim dhe shpresë, të epokës mjekut të pilotave, besim e shpresë që do të vijojë edhe në këtë botë të mbushur me kompleksitet. Libri është original për një jetë të jetuar vullshëm në të gjithë dimensionet jetësore larg mbingarkesave e sforcimeve, por e mbushur me dokumente arkivore e familjare. E bukura qëndron tek e thjeshta dhe e mira, plot ndjenjë dhe njerëzore. Libri memorial kujtese për doktor Karemanin është një etalon mirësie, prush atdhetarie, shembull që transmeton mesazhe të fuqishme të dashurisë njerëzore, për mënyrën e depërtimit në botën njerëzore me thjeshtësi dhe dashuri. Ky ishte një “provim” i vështirë për shokun tonë Astritin (autorin e librit), që në 360 faqe të librit “Një jetë kushtuar mjekësisë”, në të tetë pjesët e tij, ka

përmbyshur me sukses të plotë, një ndër detyrat më të vështira të jetës së tij.

Sevasteri, fshati i lindjes dhe origjina

Kushdo ka kaluar në Sevaster, i ka rënë në sy nyja e hershme historike si një kala natyrore, që lidh gjithë Shqipërinë jugore, sepse rruga nëpër shekuj kalonte faqes së malit, për në Tepelenë, Memaliaj, Gjirokastrë, Janinë, Selanik e më tej, në qendrën e Perandorive. “Rrapi i Sevasterit”, ishte pika turistike me ujë e ftohtë, ku qëndronin nëpunësit e kohëve antike që i dhanë edhe emrin fshatit, stacioni ku ndalonin autobusët, pushonin, udhëtarët, fshati me postë-telegraf, qytezë rrëzë Tartarit, fshat me shkollën: “Drita e Diturisë” ndër të parat dhe të rrallat në Vlorë, me njerëz drejtues me zë, specialiste e kapacitete, në shumë fusha, me gjurmë thesar për origjinën të gdhëtur në Amfiteatrin e kësaj treve me tradita të çmuara të rralla, të ruajtura, pasuruara dhe transmetuara nëpër breza shekujve.

(Në kujtim të Kareman Hasko (Aliaj), partizanit pionier, doktorit të radhëve partizane, doktorit ushtarak të pilotëve që na rikthehet nga kaltërsitë e qiellit shqiptar nga pena e të birit Astrit Aliaj me libër të posaçëm dhe të dedikuar “Mjeku i kaltërsive”, një libër-përmendore për kujtimin e tij njerëzor. Ai ishte lindur më 6.1.1928, Ishte rreshtuar në radhët partizane, në Br23S, infermjer, ndihmësmjek, student në ish-Jugosllavi (Boegrad dhe Lubjanë) nga dhjetori 1947 deri në Maj 1948 dhe në ish-BRSS (Kiev) nga 19.9.1948 deri më shtator 1951, vit kur ju dha edhe grada “nëntoger” dhe doktor ushtarak, gjithçka e dokumentuar në dosjen personale me nr. 7372 të oficerit doktor Kareman Abas Hasko (Aliaj). Edhe aparati i librit është një gjetje e spikatur për monografinë “Një jetë kushtuar mjekësisë”, ku përfshihen edhe art grafik dhe kopertina nga Alketa e Dorela Aliaj si dhe redaktimi nga mjeshtri Kristaq Shabani që ka shkruar dhe përsiatjen: “Profil “obelisk” i spikatur i mjekut me shkathtësi mendjeje dhe shkathtësi veprimi profesional”. Doktor Kareman Hasko (Aliaj), përmbushi me nder “betimin e Hipokratit” pikë për pikë duke e kaluar jetën si mjek profesionist, në pastërti dhe dëlirësi, dhe kështu ai mbeti deri në ditën e dëshmorëve të 2018-ës dhe përgjithmonë mirënjohje, nder, krenari e Aviacionit Ushtarak, por dhe mbarë trevës së Labërisë).

Këtu në këtë fshat ishte lindur Kareman Abas Hasko (Aliaj), që vjen për shokët, miqtë, kolegët në librin e Astrit Aliaj “Një jetë kushtuar mjekësisë”. Pjesa e parë “Fëmijëria” vjen e përshkruar në mënyrë emocionale që sikurse thotë redaktori i librit Kristaq Shabani, “ka arritur në skalitjen e profilit, një detyrë sa e vështirë, aq dhe e përgjegjësime”. Vendlindja, pozicioni gjeografik, vlera e qyteti Amantia, qytet i lashtë, vërtetues i faktit të lashtësisë së banorëve të këtyre trojeve dhe aspektet e zhvillimit kulturor, prejardhja e emrit të fshatit Sevaster, bazuar në të dhëna arkeologjike e shpjegime etimologjike; paraqitja e ardhjes në jetë dhe jeta zanafillore e Karemanit, ku jepet dhe një “organogramë” e pemës gjenalogjike e familjes, fisit...”. Në këtë libër tradita, zakonet, doket, përshkrimet e përfaqësuesve të brezave të familjes, mjedisve banuese si dhe të dhënat bibliografike të bazuara fuqishëm në dokumenta arkivore e bëjnë publikimin serioz dhe mjaft të

besueshëm. Prioriteti dhe dashuria për arsimimin, të dëshirës së gjithë trevës për dije e arsimim, të bindin në idenë e rrugëtimit të ardhshëm që e fton lexuesin të jetë besnik librit për njohuritë që vendos në dispozicion serviren duke marrë përmasën e nevojshme për të realizuar tejnjohjen. Karemani fëmijë e ndjente veten të bekuar për vendlindjen e tij dhe dashurinë për të e kishte të shenjtë, sepse në ditë të shenjtë kishte lindur. Këtë vend të bekuar bashkëfshatarët e tij e kishin ngritur në art, kur këndonin: “Sevaster- Kudhës Grehoti,/o vend i bekuar nga Zoti”. Bijtë e Sevasterit e dinin mirë se një popull pa kulturë e shkollë sundohet lehtë nga të huajt, prandaj përpjekjet dhe lufta për çeljen e shkollës, kanë qënë pjesë e luftës për të siguruar lirinë e mëvehtësinë për këtë krahinë, të njohur për zhvillimet historike, dhe që quhej “Kudhës Grehot”, përpara vitit 1945. Fakt është se për përhapjen e gjuhës shqipe, çeljen e shkollës së parë në këtë trevë, ndër 10 skol-

lat e para në qarkun e Vlorës, ku përmblihdite mbi 9 fshatra në kufijtë e Vlorës me Tepelenën dhe Mallakastrën, shënohet në memorijen e njerëzve, viti 1911, kur njihet hapja e shkollës së Sevasterit e transmetuar brezave, e njohur historikisht dhe e pasqyruar edhe në shtypin e kohës. Fëmijëria është një stacion në udhën e jetës dhe është në fakt pranvera e shpirtit, përjetimi më njerëzor i hal-leve dhe brengave të kohës të cilat Kareman Hasko (Aliaj) i përjetoi sikurse gjithë bashkëmoshatarët e tij. Kapitulli “Fëmijëria” është mbushur me emra e detaje, një mekanizëm i domosdoshëm informativ për lexuesin, që në rreth shtatëdhjetë faqe mbyllet me pushtimin fashit italian, që edhe pse Karemani ishte në klasën e tretë si gjithë bashkëmoshatarët, ishte koha kur nuk kishte më fëmijëri. Fëmijëria e kishte humbur kuptimin dhe nocionin e të qenit e tillë. Kishte ardhur koha e burrërimin të parakohshëm, kur robëria kërkonte kundërpërgjigje, për të rrëmbyer armët sikurse kishin bërë baballarët e tyre në vitin 1920 dhe në lufrat e tjera për liri.

Antifashizmi trend i kohës dhe detyrim për çdo shqiptar gjatë LIIB

Pjesëmarrja në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare (LANÇ) është pjesa e dytë e librit, ku “Dashuria për Atdheun, lind nga dashuria për familjen” është e përshkruar me “kohë e zezimit”, që është “pushtimi kulturor” italian fashist, që në fakt krijoi stanjacion dhe robëroi shqiptarët. Në libër del në pah aktiviteti patriotik në çetën e Sevasterit, por nuk ngurohet dhe hapur flitet edhe për pjesëmarrje të “gabuar” në formacionet e ish-Ballit Kombëtar, e justifikuar nga fakti që vinte nga mituria. Por sikurse shpjegohet në rreshtat e librit solli pasoja të shumta, sorollatje, jo pak andaralla për doktorin deri në mos pranim në partinë e asaj kohe, gjatë gjithë jetës, paçka se në fakt ishte larguar nga formacionet e Ballit dhe kishte përqafuar idealet antifashiste të partizanëve shqiptarë, duke ju bashkuar partizanëve të Brigadës së 23-të Sulmuese. Në fq 86, flitet qartë për ngjarjen e qershorit të vitit 1944 ku kushërirri Çuman Mehmeti (Aliaj), bënte pjesë në çetën e Ballit në Amonicë dhe prej Amonicës shkuan në Kropisht e në Vlorë, duke e marrë edhe Karemanin me vete në atë kohë një 15 vjeçar. Ndërkohë që është më se e njohur se aktiviteti i kësaj brigada sikurse gjithë brigadat e tjera ka qenë mjaft i suksesshëm gjatë LANÇ-it edhe përtej kufijve administrativë shqiptarë. BrXXIIS ishte formuar në Zall-Mner të Tiranës, më 21.9.1944, nga batalionet “Krujë-Ishëm”, “Dajti”, e “Mati” dhe që kishte rreth 700 partizanë të organizuar në tri batalione. Që me krijimin u fut në përbërjen e DIS, ku mori pjesë në luftën e Tiranës. Forcat e saj për afër dy muaj rresht goditën autokolonat gjermane në rrugën Vorë-Milot, si dhe garnizonet e fortifikuara të armikut në Krujë, Vorë e Ura e Zezë. Ndërkohë shpartalloi forcat e Legalitetit në zonën e Ishmit dhe me veprimet e saj luftarake bëri që 400 forca të tyre të dorëzoheshin. Në fund të muajit tetor organizoi mbrojtjen e bregdetit në zonën e Ishmit, për të

ndaluar çdo zbarkim të mundshëm të forcave anglo-amerikane në atë drejtim. Pas goditjeve të ashpra e të vijueshme, më 1 nëntor 1944 çliroi Krujën. Me urdhër të Shtabit të Korparmatës IS më 17.11.1944 BrXXIII S në bashkëveprim me BrXXIV S vazhdoi ndjekjen e forcave gjermane që po tërhiqeshin në rrugën Milot-Lezhë-Shkodër, duke i shkaktuar armikut humbje të mëdha, më 18 nëntor ‘44 çliroi Milotin, më 23 nëntor ‘44 Lezhën dhe së bashku me forcat e disa brigadave të tjera, mori pjesë në çlirimin e Shkodrës. Me urdhër të Komandës së Përgjithshme, kaloi kufirin shtetëror dhe vazhdoi veprimet luftarake në Mal të Zi bashkë me BrVIIS e BrXX-IVS për të ndihmuar në çlirimin e popujve të Jugosllavisë, kryesisht të shqiptarëve që jetonin në këto troje. Në faqet e librit lexuesi gjen të faktuar rrugëtimin e Karemanit dhe kalimin me forcat partizane, kur ranë nën breshëritë e plumbave të nazistëve gjermanë në Shkodër. Por fakt është se “incidenti” me forcën kundërshtare politike që humbi luftën dhe u bashkua me pushtuesin e ndoqi pas si një “hije e zezë”, si një damkë biografike edhe pse rrugën e jetës e çau me guxim dhe zotësi. Ndërkohë që është i njohur se gjithë fisi dhe fshati i Karemanit kishte përqafuar fuqishëm luftën partizane si pjesë e kolacionit të madh antifashist botëror. Vëllai i tij Tefiku ishte partizan i BrVS hero i popullit. Edhe pse me “njollë në biografi” Karemanin dhe shokët e tij i përballuan me nder sfidat më të mëdha të jetës: “luftën partizane” dhe dolën fitimtar në një Shqipëri të sfilatur por të lirë.

Shkolla – kudhra ku u përgatit e ardhmja e doktorit të pilotëve

Kareman Hasko (Aliaj) është pjesë e historikut të aviacionit, është një copëz e jetës qiellore shqiptare. Paslufta ishte një oqean pafundësisht perspektivash për t’u shkolluar dhe rritur profesionalisht, dhe për të gjetur veten në shoqëri. “Rruga drejt mjekësisë”, “Kthimi në Atdhe dhe fillimi i karrierës ushtarake”, “Martesa dhe karriera”, “Fillimi i jetës bashkëshortore”, flasin për thelbin e jetës dhe burrërimin në shkollin dhe profesion por edhe në jetën familjare, për detyrimet e mëdha në jetë që vijnë kaq pozitivisht dhe me ndjesi reale dhe vërtetësi jetësore.

Nuk ishte më partizani i thjeshtë, infermieri partizan, ndihmës mjek në Spitalin e Përgjithshëm Ushtarak në Tiranë, por student për mjekësi, nëpër fakultete në Beograd, Lubjanë, në Kiev, në Tiranë, mjek në tre aerodrome, mjek në Shkollën e Aviacionit në Vlorë deri në daljen në pension, duke e përmbyllur me krakteristikën figurative: “T’i linde në ditën e “Ujit të Bekuar”, u largove në ditën që nderojmë Dëshmorët e Atdheut”.

Libri i Astrit Aliaj është një qëmtim plot sqimë në përditshmërinë e jetës, në emocione, gëzime, trishtime, guxime, në luftën për për dije e profesionalizëm, në botën e madhe të pamatë shpirtërore, në zbatueshmërinë e betimit “vargmal” të Hipokratit, babait të mjekësisë në botë, në bardhësinë e bluzës por më shumë në bardhësinë e karakterit dhe të figurës intelektuale e fisnike, në interesimin për shëndetin, rigorozitetin profesional, në përkushtimin ushtarak. Ai punoi dhe jetoi në një periudhë kur aviacioni e filloi nga zërua dhe u ngjit në majat e lavdisë së kohës me rreth 240 mjete ajrore avionë e helikopterë, një flotë e jashtëzakonshme për kohën dhe për mundësitë shqiptare. Shqipëria pati një Shkollë të Aviacionit, në historikun e së cilës shkruajti bindshëm emrin Kareman Aliaj. Një shkollë që do të jetojë gjatë në kujtesën shqiptare dhe nuk dihet se kur do të ketë sërish një të tillë. Aviacioni, për nga natyra tepër i veçantë me njerëz të veçantë, që kërkonte shumë trajnim e sakrificë rigorozitet dhe kërkesë të lartë sepse fiziologjia e fluturimit, dhe sidomos ajo për përdorim luftarak kërkojnë elementët më të mirë psiko/fizike të njeriut. Këto element pilotët tanë i morën fillimisht në shkollat e aviacionit jashtë në ish-Jugosllavi, në Bashkimin Sovjetik dhe në Kinë, meqenëse atje ofroheshin kushtet më të mira për trainimin e pilotëve luftarakë. Pas prishjes me Bashkimin Sovjetik në baza ideologjiko-politike, ashtu si edhe me fushat e tjera të ekonomisë, ushtria filloi të vuante menjëherë pasojat e prerjes së ndihmave ushtarake sovjetike. Por sektori që ndjehu më shpejtë mungesën ishte aviacioni. Prandaj edhe lindi nevoja e një shkolle për pilotë në vendin tonë dhe sigurisht edhe mjekun e donin shumë të përgatitur dhe kompetentë. Ishte periudha kur Ushtria


Popullore kishte nevoja emergjente për furnizimin me gjak të ri të radhëve të aviacionit ushtarak, por dhe ideologjia e kohës, “Të mbështetemi në forcat tona”. Kështu u vendos krijimi i një shkolle e cila kishte rol kyç në përgatitjen e pilotave dhe të teknikëve të aviacionit ushtarak, sipas përvojës së marrë nga shkollimet në ish-BRSS. Më 11 Maj 1962, me dekretin e Presidiumit të Kuvendit Popullor, u vendos hapja zyrtare e Shkollës së Lartë Ushtarake të Aviacionit. Pilotët përgatiteshin me një program dy vjeçar, kurse pas vitit 1964 programet e shkollës u ngritën në nivel tre vjeçar. Në vitin 1976, Shkolla e Lartë Ushtarake e Aviacionit, sipas kërkesave në rritje të armës së aviacionit, u bë institucion me program tre vjeçar për gjithë specialitetet, ku shkollës i shërbente si pistë e dheut në Pish Poro (Akërnj) e vendosur pranë Lagunës së Nartës në veri të qytetit të Vlorës, e ndërtuar më 1950 dhe shërbente si bazë rezervë e Regjimentit të Kuçovës. Komandanti i parë i shkollës ka qenë kolonel Babçe Faiku, me kontribut të madh në formatimin e shkollës që ishte njëherazi edhe mik e shok me doktor Karemanin. Studentët e parë të aviacionit shqiptar, si Koço Biku, Bardhyl Lubonja, J.Bakshevani, P.Lengu, Sefedin Tomçini (dëshmor), Petraq Koroveshi, Thanas Papa, Foto Lako, S.Shahini, Kostandin Sadiku, Flamur Micko, Nehar Jazenxhiu, Naun Todo, Haki Jupasi, Mahmut Hysa, Bardhosh Hasani, Hasbi Serani, Avdi Gjomema, Agim Nanaj, Kaso Petroshati, Hamit Ulqinaku, Guri Merko, Petrika Kostani, Arqile Kosta, Servet Murati, Isa Arapaj, Astrit Jaupi etj. Por edhe grupet e studentëve që pasuan kishin një doktor të apasionuar që i niste dhe i priste në pistat e avionëve. Dr Karemani ishte bërë për studentët e pilotimit në Shkollën e Aviacionit një shok, mik e vëlla, një njeri depërtues në shpirtin e pilotëve dhe që ju dhuronte kënaqësi e buzëqeshje për misionin e vështirë të pilotimit ushtarak shqiptar. Doktor Karemani edhe kur Shkolla e Aviacionit u kthye në “Shkollën e Trupës” dhe që shërbeu edhe për helikopterët i përjetoi me ndjenjë ndryshimet që çuan gradualisht deri në eliminimin e shkollës që ishte sa vitale aq edhe domosdoshmëri për kohën. Doktorin

e gëzonte çdo sukses dhe ngritje në strukturat ajrore shqiptare, që në fakt në këto vitet e fundit janë në pritje të ringritjes, me qëllim që tradita të mos humbasë dhe të marrë vendin që meriton në zhvillimin teknologjik dhe profesional të vetkontrollit të plotë të hapësirës ajrore shqiptare. Janë një galeri jetësore tipash e karakteresh me të cilët është ndeshur në jetë doktor Karemani dhe që vijnë natyrshëm në këtë libër si vlerë e kontribut, profesionalisht i arrirë, plot ndjenjë e mbresa, si pikë referimi për pasardhësit, të pashkëputur nga mjedisi familjar, kulturor, i lidhur fortë me gjenealogjinë familjae, fisin, fshatin, krahinën, mbarë trevën e Labërisë. Një libër që shpalos vlera e cilësi, karakteristika, temperamente, traditë, reflektime, triumfe, arsimim, mirësjellje, norma, ligje, përkushtim serioz ndaj detyrës.

Ligji-Betim i Hipokratit i lindur e zotim historik edhe për doktor Karemanin

Doktori nuk e harroi kurrë betimin dhe ndjenjën sublime të detyrës. Fakt është se Betimi i Hipokratit e bëri Kareman Hasko (Aliaj) mjek të pilotave dhe njerëzve të thjeshtë. Njeri me dije të thelluara sepse që në shkollë e kishte përvetësuar dhe e dinte mirë se Hipokrati 2500 vjeçar, ishte ai që ndau magjinë nga mjekësia, Hipokrati i epokës së Perikliut, që dijet rreth tij erdhën deri në epokën shqiptare të aviacionit ku shërbeu doktori i kaltërsive, doktor Karemani dhe gjithë kolegët e tij. Kushdo nga doktorët sikurse dhe doktor Karemani e dinte se, babai i mjekësisë konsiderohet një nga figurat më të shquara në historinë e mjekësisë dhe tradicionalisht është quajtur “Babai i Mjekësisë”, por ai i dha frymë e jetë mjekësisë humane, ku humanizmin dhe njerëzillëkun e përqafuan një plejadë e shkëlqyer mjekësh shqiptare sikurse edhe doktor Karemani. Doktor Karamani thoshte se “Ecja është ilaci më i mirë i njeriut”, ndërkohë, që “fluturimi është vetëm për ekselentë”. Doktori e dashuroi artin e mjekësisë prandaj edhe u bë më shumë se njerëzor përgjatë jetës e karrierës ushtarako-mjekësore. Për doktor Karemanin ka me dhjetra e qindara mendje e zemra që e kujtojnë për atë çfarë ishte dhe çfarë bënte sepse “Betimi i Hipokratit për të ishte i shenjtë, ishte ligji moral i mjekëve profesionistë”, ligji-Betim i Hipokratit i lindur si zotim historik, por që në fakt ishte kthyer në betim të shkruar rreth dy shekuj më vonë, betim që erdhi natyrshëm tek çdo mjek shqiptar. Profesionin e mjekut e bëri doktor Karemanin një njeri profesionist plot virtyte humane dhe që ofronte dashuri njerëzore sikurse kishte mësuar në tre shkolla, branda dhe jashtë vendit. Në aparatat e librit vërtetësia dokumentare e bën monografinë sa solide aq edhe të besueshme në sytë e lexuesit, të miqve, shokëve e kolegëve, çka flet për seriozitetin e shkallës maksimale dhe përkushtimin e autorit Astrit Aliaj. Për këtë arsye mjeku i burrave të kaltërsive, i heronjve të ajrit, do të jetojë përjetësisht në një vepër të të birit dhe në zemër të shokëve, miqve e kolegëve si etalon mirësie.





Ministri Mehaj dhe gjenral Rama, të cilët janë të ftuar zyrtarisht nga presidenti i AUSA-së, gjeneral Carter F. Ham, patën mundësinë të njihen me produktet e ekspozitës ushtarake dhe shumë prezantime të tjera të zhvillimit profesional, të ofruara nga liderë ushtarakë të Ushtrisë Amerikane dhe të Departamentin Amerikan të Mbrojtjes.



Ekspozita Vjetore e Shoqatës së Ushtrisë së Shteteve të Bashkuara

Ministri Mehaj dhe gjeneral Rama vizitë dhe takime të suksesshme në SHBA

Ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj i shoqëruar me Komandantin e FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama dhe pjesëtarët e tjerë të delegacionit, kanë marrë pjesë në ceremoninë e hapjes së Ekspozitës Vjetore të Shoqatës së Ushtrisë së Shteteve të Bashkuara (The Association of the United States Army) – “AUSA 2021”. Ministri Mehaj dhe gjeneral Rama, të cilët janë të ftuar zyrtarisht nga presidenti i AUSA-së, gjeneral Carter F. Ham, patën mundësinë të njihen me produktet e ekspozitës ushtarake dhe shumë prezantime të tjera të zhvillimit profesional, të ofruara nga liderë ushtarakë të Ushtrisë Amerikane dhe të Departamentin Amerikan të Mbrojtjes. Në po të njëjtën ditë, ministri Mehaj dhe gjeneral Rama nderuan dhe përkujtuan me respektin më të lartë, të gjithë ushtarakët amerikanë –dëshmorë të lirisë dhe paqes kudo në botë. Pas nderimit me kurorë lulësh pranë Varrit të Ushtrisë të Panjohur në Varrezat Kombëtare në Arlington, ata vizituan edhe Muzeun e Kompleksit Memorial, ku ministri Mehaj dhuroi një replikë të helmetës



iliro-dardane. Kjo helmetë u vendos në vend të rëndësishëm të Muzeut, si simbol i mirënjohjes, nderit dhe respektit

të përjetshëm të kombit tonë për SHBA-në, kombin amerikan dhe ushtarët e saj. Në po të njëjtën ditë, ministri Mehaj së

bashku me gjeneral Ramën, takuan Drejtuesin e Agjencisë së Bashkëpunimit të Sigurisë së Mbrojtjes të Departamentit

të Mbrojtjes së SHBA-së, znj. Heidi Grant. Me znj. Grant ata vazhduan diskutimet e nisura nga takimi i fundit në Split, lidhur me format e thellimit të bashkëpunimit dhe zbatimit sa më të suksesshëm dhe efektiv të konceptit të blerjeve ushtarake, përmes Programit të Shitjeve të Jashtme Ushtarake të Departamentit të Mbrojtjes të SHBA-së. Ministri Mehaj dhe znj. Grant u pajtuan se bashkëpunimi midis SHBA-së dhe Republikës së Kosovës udhëhiqet nga vlera dhe interesa të përbashkëta, andaj theksuan se do të intensifikojnë edhe më shumë angazhimet në mënyrë që të përmbushen qëllimet e përbashkëta të mbrojtjes. Gjatë ditës së dytë të ekspozitës “AUSA 2021”, ministri Mehaj takoi edhe gjeneralin amerikan në pension Randal Dragon, drejtor i Kompanisë Këshilluese të Agjencitë Federale Civile dhe të Mbrojtjes (LMI). Me gjeneral Dragon ata diskutuan, përveç tjerash, edhe për prokurimin dhe blerjet ushtarake si dhe shkëmbyen eksperiencat e ndërsjella lidhur me këto çështje.


Bashkëpunimi ushtarak Kosovë-Maqedoni e Veriut, me rëndësi shumë të madhe për sigurinë dhe stabilitetin rajonal dhe më gjerë

Me nderime të larta ushtarake, në Ministrinë e Mbrojtjes u prit shefi i shtabit të përgjithshëm të forcave të armatosura të Republikës së Maqedonisë së Veriut, gjenerallejtënant Vasko Gjurchinovski. Në fillim, atij i dëshiroi mirëseardhje komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama dhe më pas u prit në takim nga ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj. Me këtë rast, ministri Mehaj vlerësoi lartë rolin dhe kontributin e Forcave të Armatosura të Maqedonisë së Veriut në kuadër të KFOR-it dhe misionet tjera në kuadër të NATO-s. Gjithashtu, ai vlerësoi bashkëpunimin e deritashëm ushtarak mes dy forcave, me besimin se do të thellohet edhe më tej edhe në të ardhmen. Pas takimit me ministrin Mehaj, gjenerallejtënant Gjurchinovski u prit në zyrën e komandantit të FSK-së, gjeneral Ramës, ku pas takimit kokë më kokë ata diskutuan edhe nivel të dy delegacioneve. Gjatë këtyre takimeve u vlerësua lart bashkëpunimi ushtarak ndërmjet forcave të të dy vendeve duke diskutuar për konkretizimin e aktiviteteve të përbashkëta në kuadër të planit të bashkëpunimit bilateral. Me



theks të veçantë u diskutua nevoja për intensifikimin e bashkëpunimit në fushën e arsimimit dhe stërvitjes të dy forcave. Më pas, gjeneral Gjurchinovski dhe delegacioni i tij vizituan kazermën e FSK-së në Pomozatin, respektivisht

Qendrën Ndërkombëtare të Trajnimit në kërkim-shpëtim. Kjo vizitë u realizua në kuadër të planit të bashkëpunimit ushtarak, bazuar në Memorandumin e Mirëkuptimit në mes ministrive të mbrojtjes së dy vendeve.



Në Shtip ne nuk vendosëm rastësisht të gjejmë këtë kapacitet të NATO -s, Grupin e Batalionit të Këmbësisë së Lehtë, sepse menduam se kemi mjaft të rinj dhe përvojë dhe se kemi një numër të mjaftueshëm të pjesëtarëve të Armatës të cilët do të jenë në gjendje të arrijnë kriteret e nevojshme. Në këtë periudhë, fokusi ynë kryesor si në aspektin e stafit ashtu edhe në aspektin e pajisjeve dhe në aspektin e kushteve cilësore të punës ishte vërtetë Shtipi.



Grupi i batalionit të Këmbësisë së Lehtë në Shtip

Kushte më moderne të punës, rindërtimi i plotë i objekteve të Armatës, brenda afatit

Ministrja e Mbrojtjes Radmilla Shekerinska vizitoi para disa ditësh kazermën e Shtipit ku ndodhet Grupi i Batalionit të Këmbësisë së Lehtë, e cila është edhe njësi ushtarake e NATO -s dhe ku për momentin në fazën e rindërtimit të plotë janë dy ndërtesa që do të marrin një pamje të re dhe moderne, dhe me efikasitetin më të lartë të energjisë.

“Në Shtip ne nuk vendosëm rastësisht të gjejmë këtë kapacitet të NATO -s, Grupin e Batalionit të Këmbësisë së Lehtë, sepse menduam se kemi mjaft të rinj dhe përvojë dhe se kemi një numër të mjaftueshëm të pjesëtarëve të Armatës të cilët do të jenë në gjendje të arrijnë kriteret e nevojshme. Në këtë periudhë, fokusi ynë kryesor si në aspektin e stafit ashtu edhe në aspektin e pajisjeve dhe në aspektin e kushteve cilësore të punës ishte vërtetë Shtipi. “Edhe sot jam e kënaqur që mund të dëshmoj këtu se aktivitetet në lidhje me rinovimin serioz të dy ndërtesave të kazermës po shkojnë sipas planit, të përshpejtuara dhe pres që të gjitha të përfundojnë brenda afateve të përcaktuara”, tha ministrja.

Shekerinska tha se njësia e Shtipit është vendosur si një nga prioritetet në zhvillimin e Armatës.

“Përveç rritjes së pagave dhe shtesave, përveç faktit se fokusi në pajisje, armatim, mbrojtje, uniforma, pajisje sportive u vendos në njësinë në Shtip, ne edhe në aspekt të investimit në infrastrukturë tregojmë sa e rëndësishme është njësia e Shtipit, si dhe kazermat e Shtipit për ne. Bëhet fjalë për rinovim të plotë të ndërtesave që janë tashmë më të vjetra se 50 vjet dhe të cilat nga ndërtesat e vjetra dhe të mirëmbajtura në mënyrë të pamjaftueshme do të shndërrohen në ndërtesa moderne dhe me efikasitet energjetik, ku pjesëtarët e Armatës dhe veçanërisht pjesëtarët e Batalionit të Këmbësisë së Lehtë do të jenë në gjendje të punojnë vërtetë në kushte shumë më të mira. “Do të fitojmë më shumë se 3,000 m2 hapësirë të rinovuar plotësisht, moderne, me efikasitet energjetik, me një sistem të plotë të shuarjes së zjarrit që do të garantojë siguri të shtuar,” tha Shekerinska. Ajo shtoi se në këtë mënyrë ne tregojmë se çfarë do



“Përveç rritjes së pagave dhe shtesave, përveç faktit se fokusi në pajisje, armatim, mbrojtje, uniforma, pajisje sportive u vendos në njësinë në Shtip, ne edhe në aspekt të investimit në infrastrukturë tregojmë sa e rëndësishme është njësia e Shtipit, si dhe kazermat e Shtipit për ne.

të thotë të jesh një ushtri e NATO -s, dhe gjithashtu tregojmë se sa i vlerëson vendi ushtarët dhe oficerët e vet dhe sa ka ndryshuar politikën e tij për të investuar në atë që është më e rëndësishmja, ndërsa shpesh thuhet se sigurinë dhe

mbrojtja nuk kanë çmim. Aktualisht është duke u zhvilluar rindërtimi i një numri të ndërtesave kapitale të Armatës dhe Ministrisë – përveç dy ndërtesave në kazermën në Shtip, është duke u zhvilluar rindërtimi i objekteve dhe ndërtesave të

mëdha në kazermën “Goce Dellçev” në Shkup, përfshirë ndërtimin e Akademisë Ushtarake dhe një ndërtesë të madhe në kazermën “Ilinden”. Së shpejti do të fillojë rindërtimi i dy objekteve shtesë në kazermën “Ilinden” në Shkup, si

dhe objekteve në kazermat në Petrovec, Kumanovë, Tetovë dhe Veles, ndërsa po punohet për gazifikimin e kazermës në Petrovec dhe Kumanovë, e cila në mënyrë të konsiderueshme ndikon në ruajtjen e mjedisit.



Qendra e Personel Rekrutimit

Një hap i sigurt drejt suksesit

Ministria e Mbrojtjes së Shqipërisë në kuadër të bashkëpunimit me aleatin tonë strategjik SHBA, ofron kuota studimi për studentët tanë

Ministria e Mbrojtjes së Shqipërisë në kuadër të bashkëpunimit me aleatin tonë strategjik SHBA, ofron kuota studimi për studentët tane. Një hap i sigurt drejt suksesit.

Mundësi studimi në Akademitë Ushtarake më të mira të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

18 kuota studimesh gjithsej;
- 6 kuota studimi në Akademinë e Forcave Ajrore
- 6 kuota studimi Akademinë e Forcave Detare
- 6 kuota studimi në Akademinë Ushtarake West Point
Dokumentat pranohen deri më 15 Nëntor 2021.

Qendra e Personel Rekrutimit kërkon të përzgjedhë 6 (gjashtë) kandidatë për çdo Akademi Ushtarake (Akademinë e Forcave Ajrore, Akademinë e Forcave Detare dhe Akademinë West Point) në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, për vitet akademike 2022-2026. Kandidatët e përzgjedhur do të jenë pjesë e seleksionimit të mëtejshëm nga vendi pritës.

Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit pranë Qendrës së Personel Rekrutimit është deri në 15 nëntor 2021.

1. Kriteret e pranimit të kandidatëve:

- Të jetë shtetas shqiptar.
- Të mos jetë i dënuar nga gjykata për vepra penale.
- Të mos jetë në ndjekje penale
- Të mos jetë në proces gjykimimi penal nga gjykata.
- Të mos ketë probleme me deportimin.
- Të mos jetë përdorues i lëndëve narkotike dhe alkolit, për të cilat do të paraqesin testet e kryera.
- Të mos jetë person i dyshuar nga organet e zbatimit të ligjit për veprimtari të kundërligjshme apo kriminale.
- Të jetë në moshë jo më pak se 18 vjeç dhe jo më shumë se 22 vjeç, në ditën e fillimit të vitit akademik (1 shtator 2022).
- Të ketë gjatësinë trupore jo më pak se 165 cm për meshkujt dhe jo më pak se 160 për femrat.
- Të ketë kryer arsimin parauniversitar brenda ose jashtë vendit, të njohur dhe ekuivalentuar nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve të Republikës së Shqipërisë. Në momentin e aplikimit kandidati duhet të paraqesë dokumentat e përfundimit të arsimit. Kandidatët që janë duke ndjekur studimet e vitit të fundit duhet të paraqesin një vërtetim mbi rezultatet e dy viteve të para dhe në përfundim të studimeve duhet të paraqesin diplomën dhe certifikatën e notave.

• Të ketë notën mesatare të arsimit parauniversitar, jo më pak se 7 (shtatë).

• Të mos jetë i martuar.
• Të mos jetë bartës i virusit HIV, Hepatit B dhe SST (Sëmundje Seksualisht

të Transmetueshme), të mos ketë kaluar apo të vuajë ndërkohë nga sëmundje të tjera të zemrës, veshkave, hepatike, pulmonare, neuropsikiatrike, sistemit lokomotor (sistemit kockor dhe lëvizjes) apo të mos jetë përdorues i lëndëve narkotike.

- Të rezultojë kalues në testet fizike, shëndetësore, intelektuale, gjuhësore ose trajnuese, që zhvillohet nga vendi pritës në Shqipëri ose pranë akademive ushtarake jashtë vendit.

- Të zotërojnë gjuhën angleze në të lexuar, të shkruar e të folur dhe të sigurojnë mbi 75 pikë në testimin ALCPT. Ata duhet të jenë regjistruar për zhvillimin e testeve online të TOEFL dhe SAT ose ACT.

- Të rezultojë kalues në testet fizike, shëndetësore, intelektuale, gjuhsore ose trajnuese, që zhvillohen nga vendet partnere në vendin tonë ose pranë shkollave ushtarake jashtë vendit, me qëllim



pranimin në shkolla ushtarake.

- Të jetë shpallur fitues në përfundim të konkurimit.
- Të plotësojë kushtin e sigurisë.
- Të jetë vlerësuar i aftë për të shërbyer në FA gjatë ekzaminimit mjekësor në Njësinë Mjekësore Ushtarake.
- Kandidatët nuk mund të regjistro-

hen për ndjekjen e studimeve në institucionet arsimore ushtarake jashtë vendit, në rast se: a. Kanë kryer më parë të njëjtin nivel arsimor ushtarak brenda ose jashtë vendit. b. Kanë qenë kontingjent i Forcave të Armatosura për ndjekjen e studimeve ushtarake brenda dhe jashtë vendit dhe nuk i kanë përfunduar ato.



- Kandidati që nuk plotëson qoftë edhe një nga kriteret e përmendura më sipër, s'kualifikohet.

2. Dokumentet për regjistrim:

- Kandidatët për regjistrim duhet të paraqesin pranë Zyrës së Pritjes të Qendrës së Personel Rekrutimit, Tiranë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Kërkesë me shkrim për ndjekjen e studimeve ushtarake, ku të specifikohet institucioni arsimor dhe preferenca e degës për të cilën aplikohet.

- Formular me të dhënat personale sipas formatit të përcaktuar, Aneksi A.

- Fotokopje e noterizuar e dokumentit zyrtar (diplomës) që vërteton përfundimin e arsimit përkatës së bashku me certifikatën dhe listën e notave, ose vërtetim që ka mbaruar dy vitet e para të arsimit me listën e notave.

- Fotokopje e kartës së identitetit.
- Fotografi për dokument (4x6), 2 (dy) copë.

- Fotokopje të pasaportës e vlefshme për jashtë shtetit.

- Certifikatë për TOEFL, SAT (ACT), ose dokument i cili vërteton se aplikanti është regjistruar për testimet që zhvillohen online për TOEFL dhe SAT ose ACT.

- Raport mjekësor i aftë për të kryerjen e studimeve, të lëshuar nga mjeku i familjes i qendrës shëndetësore të vendbanimit të kandidatit, i shoqëruar edhe me një raport shpjegues, ku deklarohet se kandidati është i shëndetshëm, nuk ka sëmundje kronike, infektive, të shëndetit mendor në anamnezën e tij personale dhe nuk është përdorues i lëndëve narkotike.

- Ekzaminimet mjekësore për agjentë infektiv (Hepatit B, Hepatit C, HIV/AIDS, Sifiliz), grupin e gjakut dhe lëndët narkotike, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut dhe/ose bankat e gjakut apo drejtoritë e Shëndetit Publik në rrethet ku banojnë, si dhe testet për lëndët narkotike nga laboratorët e certifikuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe mbrojtjes Sociale..

- Formularët e vetëdeklarimit, të cilët plotësohen pranë Qendrës së Personel Rekrutimit në momentin e dorëzimit të dokumentacionit.

Dokumentacioni që duhet të paraqesin kandidatët e kualifikuar në testimet e zhvilluara, brenda 10 ditëve:

- Dëshmi penaliteti.
- Vërtetim nga gjykata.
- Vërtetim nga prokuroria.
- Vërtetim nga përmbartimi.
- Raportin mjekësor të lëshuar nga komisioni mjeko-ligjor, në Njësinë Mjekësore Ushtarake.


3. Datat e testimit:

Testi i Gjuhës së Huaj
(Anglisht): 17.11.2021

Testi Fizik: 17.11.2021

Testi Intelektual: 18.11.2021

Testi Psikologjik: 18.11.2021



"Financial Times": Këtë shekull parashikohet të arrijë "kulmi i popullatës njerëzore", pas atij momenti mbijetesa do të varet nga...

Ndryshimi i klimës është afër pikës së moskthimit. Sikurse e bën të qartë raporti më i fundit nga Paneli Ndërqeveritar për Ndryshimet Klimatike (IPCC), edhe nëse emetimet e karbonit do të ndaleshin që nesër, ato që janë grumbulluar deri më tani në atmosferë janë të mjaftueshme për të shkatërruar shumë ekosisteme të planetit për dekadat e ardhshme.

Kjo është arsyeja pse samiti i ardhshëm i COP26, edhe pse shumë i nevojshëm për të promovuar zbutjen e ndryshimeve klimatike, është tërësisht i pamjaftueshëm për të adresuar axhendën po aq të rëndësishme me të cilën përballlet njerëzimi: përshtatja ndaj ndryshimeve.

Ndërsa i nxehti ekstrem, rritja e niveleve të deteve dhe thatësira, po i bëjnë sipërfaqet e planetit të pabanueshme, miliona, në mos miliarda njerëz do të detyrohen përfundimisht të zhvendosen në terrene më të përshtatshme për mbijetesë.

Sfida më e vështirë që kemi përpara nuk është zvogëlimi i emetimeve, por zhvendosja e njerëzve. As IPCC dhe as ndonjë agjenci tjetër, nuk është aktualisht e autorizuar për ta adresuar këtë çështje themelore të gjeografisë njerëzore.

Në dekadat e pasluftës, modele relativisht të parashikueshme të migrimit ndodhën si brenda ashtu edhe midis rajoneve. Për shembull, numri më i madh i emigrantëve që lëvizën brenda çdo rajoni është 23 milionë, dhe ata u zhvendosën përtej kufijve të ish republikave sovjetike.

Gjithsesi në dekadat e ardhshme, bota do të duhet të përballlet me disa zhbalancime demografike serioze. Mungesat e fuqisë punëtore në Amerikën e Veriut, Evropë dhe Azinë Veriore janë duke u bërë më të dukshme, dhe këto rajone do të kenë nevojë të hapin "rubinetet e emigracionit" në përputhje me rrethanat.

Dhjetëra miliona aziatikë të tjerë, mund të detyrohen të zhvendosen përgjithmonë në Euroazi, pasi disa pjesë të Azisë po bëhen të pabanueshme duke zhdukur mjetet e jetesës. Një numër i madh aziatikësh nga jugu dhe kinezësh, do të zhvendosen drejt veriut në territoret e gjëra të stepave të Rusisë Jugore dhe Kazakistanit, rajone që janë shumë të bollshme me tokë pjellore, dhe që janë gati të pabanuara nga njerëzit.

Disa nga këto lëvizje do të ishin të mundshme edhe pa ndryshimin e klimës, por ato janë bërë gati të sigurta për shkak të kësaj të fundit. Këtë shekull parashikohet të arrijë "kulmi i popullatës njerëzore", e cila do të mbërrijë në gati 11 miliardë.

Nga ai moment e tutje, mbijetesa do të varet shumë nga rishpërndarja e njerëzve. Qeveritë kombëtare janë



sovrane në lidhje me çështjet e migrimit. Por reagimi ndaj sfidës së gjeografisë njerëzore kërkon më shumë sesa ndërhyrje në marrëveshjet dypalëshe të migrimit.

Ne duhet që ta kapërcejmë hendekun midis diskursit politik shumë të ndjeshëm rreth migrimit, dhe strategjisë kolektive të nevojshme për të strehuar njerëzimin.

Të flasësh më shumë për gjeografi-në njerëzore sesa emigracionin, mund

të jetë një mjet retorik i fuqishëm, sepse e vë theksin tek fakti se ndodhemi në të njëjtën varkë, dhe kjo gjë e zhvendos fokusin nga sovraniteti i ngushtë kombëtar në një administrim të gjerë në nivel planetar.

Në një botë me një klimë në ndryshim, ne kemi nevojë për një ndarje të re të punës midis kontinenteve. Amerika e Jugut dhe Afrika do të bëhen gjithnjë e më shumë rajone që do të prodhojnë emi-

grantë. Amerika e Veriut dhe Euroazia duhet të thithin më shumë njerëz, dhe t'i qarkullojnë ata nga SHBA-ja Jugore dhe Azia Jugore që kanë probleme me furnizimin me ujë në zonat e brendshme më pjellore. Do të ketë pionierë klimatikë që do të ngrënë vendbanime të reja, në vende të tilla si Kanada dhe Rusia, për miliona emigrantët e ardhshëm. Ishujt e zhytur nën ujë të Paqësoritë Jugut do të duhet të braktisen për të shkuar në Australi dhe

Zelandën e Re, të cilat në fakt do të bëhen protektoratet e tyre brenda një Oqeanie kolektive dhe jo tërësisht sovraane. Vendet e sotme me probleme ekonomike dhe të shpopulluara të Vishegradit, mund të shkrihen në një federatë më të madhe për të administruar më mirë pyjet e tyre jetike, bujqësinë dhe lumenjtë, në mënyrë që të përgatiten për rimbushjen demografike nga arabët dhe aziatikët.

Në një përmbysje të tendencave të sotme centrifugale, Ishujt Britanikë jo vetëm që do të thellojnë ndarjen e burimeve të tyre, por do të përfaqësojnë qendrat kryesore në një version të ringjallur të Lidhjes Hanseatike mesjetare të porteve tregtare, që lidh Çërcillin në Kanada me Aberdenin në Skoci, dhe Kirkenes në Norvegji. Shumë studiues pyesin: po çfarë ka përtej sovranitetit? Në rast se jemi të mençur, përgjigja do të jetë "gjeografi e programueshme": ri-përshtatja e vendeve bazuar në ndryshimin e roleve të tyre në sistemin tonë global të lëngshëm.

Gjeografia e banueshme është burimi ynë më i çmuar tokësor, dhe ne duhet ta zgjedhim atë për ata që do të vijin pas nesh. Përshtatja e sovranitetit me një realitet të ri, është ajo që i detyrohem të ardhmes.

Shqipëria, vendi i ndërtuar mbi rrënjë të lashta historie

Zbulimet arkeologjike në Shqipëri kanë tërhequr vëmendjen e kujtëdo që ka qenë skeptik, për këtë vend të vogël por me një histori të lashtë të ekzistencës të tij.

Në një pellg bujqësor të pasur në afërsi të qytetit të Korçës në Shqipërinë juglindore, puna e ndërtimit të tubacionit të gazit u ofron arkeologëve një pasqyrë unike për 5.000 vjet histori në një vend që ishte jashtë radarëve të ekspertëve gjatë dekadave të sundimit komunist.

Gërmimet në afërsi të fshatit Turan, kanë zbuluar një nga varrezat më të mëdha të lashta në Shqipëri, me rreth 1.000 varrime të shtrësuar, disa prej të cilave ishin të mobiluara me shumë gjasa.

Dhe nën shtresën e poshtme janë gjurmët e një vendbanimi të rrallë neolitike të demarkuar nga vrima në tokë që mbështetën skeletet e kaluara të shtëpive të vogla.

Më shumë se 20 vende neolitike janë gjetur në Shqipëri, që datojnë përafërsisht nga shekulli i VII deri në shekullin e III të cilat janë disa prej vendbanimeve më të hershme bujqësore në Evropë. Por sipas arkeologëve, puna e tubacionit siguroi mundësinë dhe fondet për të gërmuar një zonë të pazakontë



të banuar nga ajo epokë.

Mbi tavernat mijëvjeçare, ekipi prej 50 arkeologësh që gërmonin një sipërfaqe prej 4000 metra katrorë, gjetën tre varreza nga Epoka e Hekurit, në fund të Romës dhe Mesjetës. Nuk ka gjurmë të vendbanimeve që kanë shërbyer këto varreza, por sipas arkeologëve është e lehtë të shihet pse njerëzit zgjedhën të jetonin atje... Sepse edhe sot ajo është një tokë e begatë bujqësore.

Sendet e gjetura përfshinin unaza, rrathë, vathë, rruaza qelqi, monedha ari, shumë qeramikë

duke përfshirë edhe kopjet lokale të shekullit të XI apo të X, enët e verës të popullarizuara në Greqinë fqinje, doreza dhe rroba mesjetare prej druri të punuar me fije argjendi, si dhe shtiza, thika dhe shpata. Turan, 180 kilometra në juglindje të kryeqytetit të Tiranës, është më e rëndësishmja nga rreth 30 vende që janë gjetur gjatë shtrimit të gazsjellësit nëntokësor Trans Adriatik, ose TAP, që do të sjellë gaz natyror nga Azerbaixhani përmes Turqisë, Greqisë dhe Shqipërisë, dhe në të gjithë Adriatikon në Italinë jugore.



13 Tetori, Dita Ndërkombëtare e Ndërgjegjësimimit ndaj Fatkeqësive

